

LIGJI NR. 03/L-048

PËR MENAXHIMIN E FINANCEVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË

Në mbështetje të Kapitullit IV neni 65 pika 1, Kapitulli IX neni 120 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të përmirësimit të shpenzimeve buxhetore, kapitale dhe operative, menaxhimit financiar, kontabilitetit, përgjegjësive buxhetore dhe sistemit të raportimit financiar për autoritetet publike dhe ndërmarrjet publike në Kosovë, si dhe për përshkrimin e kompetencave dhe detyrave të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave dhe autoriteteve të tjera publike rreth këtyre çështjeve,

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJIN PËR MENAXHIMIN E FINANCEVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË

PËRMBAJTJA

PJESA I

Dispozitat e përgjithshme

- Neni 1 Përkufizimet
- Neni 2 Paratë publike
- Neni 3 Ekzekutimi i kërkesave dhe detyrimeve

PJESA II

Zyrtarët dhe Institucionet e Menaxhimit të Financave Publike

KREU I

Zyrtarët dhe Institucionet në Ministri

- Neni 4 Departamenti i Thesarit
- Neni 5 Departamenti i Buxhetit
- Neni 6 Departamentet dhe njësitë e tjera
- Neni 7 Menaxheri i investimeve
- Neni 8 Autorizimi për investimin e parave publike
- Neni 9 Investimi i FKK

KREU II

Zyrtarët Financiar të Organizatës Buxhetore, Agjencisë Autonome Ekzekutive dhe Ndërmarrjes Publike

- Neni 10 Zyrtari Kryesor Administrativ
- Neni 11 Auditori i Brendshëm
- Neni 12 Zyrtari Kryesor Financiar
- Neni 13 Zyrtari i Prokurimit
- Neni 14 Zyrtari Certifikues
- Neni 15 Punësimi ose angazhimi i Zyrtarëve Financiar

PJESA III

Mbledhja dhe ruajtja e parave publike

- Neni 16 Pranimi i parave publike
Neni 17 Shpenzimi i parave publike
Neni 18 Llogaritë në Fondin e Konsoliduar të Kosovës

PJESA IV Përgatitja dhe Përmbajtja e Propozim-Buxhetit Vjetor të Konsoliduar të Kosovës

- Neni 19 Përgatitja e Kornizës Afat Mesme të Shpenzimeve
Neni 20 Përgatitja dhe rishqyrtimi i propozim-buxheteve dhe kërkesave për ndarje buxhetore
Neni 21 Përgatitja dhe Dorëzimi i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës
Neni 22 Dorëzimi në Kuvend i Propozim Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe Propozim Ligjit për Ndarje Buxhetore
Neni 23 Prioriteti i projekteve kapitale
Neni 24 Ndarjet buxhetore në mungesë të një Ligji për Ndarjet Buxhetore

PJESA V Ligjet e rishqyrtuara dhe të plotësuara të ndarjeve buxhetore dhe buxhetet

- Neni 25 Ligjet e rishqyrtuara të ndarjeve buxhetore dhe buxheteve
Neni 26 Propozimi i Ligjeve të Reja ose Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjeve

PJESA VI Rregullat për ndarjet buxhetore

- Neni 27 Skadimi i ndarjeve buxhetore në fund të viti fiskal
Neni 28 Tarifat dhe detyrimet bankare
Neni 29 Shpenzimet e paparashikuara
Neni 30 Rregullimi i ndarjeve buxhetore të organizatës buxhetore
Neni 31 Rregullimi i ndarjeve buxhetore në rast të ndryshimit të përgjegjësisë
Neni 32 Transferet me mallra dhe shërbime ndërmjet organizatave buxhetore
Neni 33 Prokurimi dhe pagimi në emër të një organizate buxhetore

PJESA VII Zotimet, fondet e alokuara, fondet e zotuar, fondet e obliguara dhe shpenzimet

- Neni 34 Kontratat që vendosin përgjegjësi për bërjen e pagesave në vitin aktual fiskal apo në vitet e ardhshme fiskale
Neni 35 Fondet e alokuara
Neni 36 Reduktimi i fondeve të alokuara
Neni 37 Fondet e zotuar
Neni 38 Pagimi, Prioritetet
Neni 39 Pagimi i Faturave dhe kërkesave për pagim nga njësitë e përcaktuara
Neni 40 Pagimi i vendimeve të prera gjyqësore
Neni 41 Kompensimi i shpenzimeve

PJESA VIII Raportimi, kontabiliteti dhe auditimi

KREU I Dokumentet dhe raportimi

- Neni 42 Publikimi i ligjit mbi ndarjet buxhetore dhe publikimi i buxhetit
Neni 43 Buxhetimi dhe regjistrat e kontabël në Thesar
Neni 44 Regjistrat kontabël të organizatës buxhetore
Neni 45 Raportet tremujore buxhetore

Neni 46 Raporti përfundimtar mbi buxhetin

KREU II Auditimi i jashtëm

Neni 47 Auditimi nga Auditori i Përgjithshëm
Neni 48 Auditimi nga jashtë i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës

PJESA IX Kufizimet në Huamarrje, Garantime, Huadhënie, Kapitalizim, Grante, Donacione dhe Subvencione

Neni 49 Kufizimet e Përgjithshme
Neni 50 Përjashtimet e Veçanta
Neni 51 Përjashtimet e Përgjithshme
Neni 52 Ministri i Financave në cilësinë e Agjentit të Vetëm të Autorizuar
Neni 53 Kufizimet në Grante, Donacione dhe Subvencione
Neni 54 Kontratat e Ortakërisë Publiko-Private

PJESA X Përgjegjësia e Ndërmarrjeve Autonome Publike

Neni 55 Grantet për Ndërmarrjet Autonome Publike
Neni 56 Njoftimi mbi Ngjarjet e Rëndësishme

PJESA XI Komunat

KREU I Dispozitat e Përgjithshme

Neni 57 Zbatimi i këtij ligji në komuna
Neni 58 Të ardhurat komunale
Neni 59 Ndhima financiare nga Republika e Serbisë

KREU II Përgatitja e Propozim Buxhetit dhe Kërkesës për Ndarje Buxhetore nga Komuna

Neni 60 Përgatitja dhe rishqyrtimi i propozim-buxheteve dhe kërkesave për ndarje buxhetore nga ZKF dhe Kryetari i Komunës
Neni 61 Shqyrtimi i Buxhetit Komunal nga Kuvendi Komunal
Neni 62 Mos dorëzimi me kohë i propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore nga komuna

PJESA XII Agjencitë e Pavarura

Neni 63 Zbatimi i këtij ligji për Agjencitë e Pavarura dhe Gjykatat
Neni 64 Të Ardhurat e Agjencive të Pavarura dhe Gjykatave
Neni 65 Procesi i buxhetimit për agjencitë e pavarura dhe gjykatat duhet të jetë i lirë nga ndikimet politike dhe afariste
Neni 66 Agjencitë e pavarura me agjencitë e përcaktuara të të hyrave

PJESA XIII Procedurat Gjyqësore dhe të Arbitrazhit që përfshijnë një Autoritet Publik

Neni 67	Procedurat e ardhshme gjyqësore ose të arbitrazhit
Neni 68	Rastet e Pazgjidhura në Gjykatë
Neni 69	Dëmet e lejueshme
Neni 70	Konflikti ndërmjet kësaj Pjese XIII dhe akteve tjera ligjore
Neni 71	Njoftimi i gjykatave, autoriteteve publike dhe Odës së Avokatëve
Neni 72	Ndarjet plotësuese buxhetore

PJESA IV Dispozitat penale dhe çështjet përfundimtare

Neni 73	Mos Depozitimi i Parave Publike në Fondin e Konsoliduar të Kosovës
Neni 74	Mbledhjet e Paligjshme
Neni 75	Mospërputhja e një organizate buxhetore me këtë ligj
Neni 76	Ndikimi i paligjshëm
Neni 77	Shkeljet nga zyrtarët publik apo shërbyesit civil
Neni 78	Suspendimi i zyrtarit publik dhe shërbyesit civil
Neni 79	Shkeljet nga personat e tjerë
Neni 80	Ndalimi i kompensimit shtesë
Neni 80	Hyrja në fuqi/Shfuqizimi i legjislacionit paraprak/Zbatueshmëria

PJESA I Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Përkufizimet

1.1 Me qëllim të interpretimit dhe zbatimit të këtij ligji – termet dhe shprehjet në vijim – kurdo që përdoren në këtë ligj - kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç nëse konteksti në të cilin këto terme ose shprehje përdoren, qartësisht ka kuptim tjetër::

-“**Fondet e alokuara**”- ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 35 të këtij ligji;

-“**Ndarje Buxhetore**”- do të thotë shuma maksimale e përcaktuar në një Ligj për Ndarjet Buxhetore e cila mund të vihet në dispozicion për shpenzim nga një organizate buxhetore gjatë vitit fiskal për shpenzim në një program të caktuar ose kategori tjetër shpenzimi ose për bartje nga një organizatë buxhetore te një autoritet publik ose ndërmarrje publike në formë të grantit.

-“**Ligji mbi Ndarjet Buxhetore**”- nënkupton ligjin i cili miratohet nga Kuvendi me të cilin autorizohen organizatat buxhetore për shpenzimin ose bartjen e fondeve publike, deri në një kufi të caktuar dhe për qëllime të caktuara, gjatë vitit fiskal.

-“**Kuvendi**”- do të thotë Kuvendi i Republikës së Kosovës.

-“**Auditori i Përgjithshëm**”- nënkupton Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës të emëruar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/18.

-“**Investimet e Autorizuara**”- do të thotë letrat me vlerë ose llogaritë deponuese të përcaktuara shprehimisht në paragrafin 1 të nenit 9 të këtij ligji.

-“**Agjenci Autonome Ekzekutive**”- do të thotë një autoritet publik i cili (i) nuk është vetë organizatë buxhetore por është pjesë e një organizate buxhetore, dhe (ii) shprehimisht kërkohet sipas një akti themelor juridik që të veprojë në mënyrë autonome ose me autonomi substanciale nga organizata buxhetore pjesë e së cilës është.

-**“AQBK”**- do të thotë Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës të themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2006/47 si dhe cilindo institucion pasues.

-**“Komisioni për Buxhet”**- do të thotë Komisioni për Buxhet i Kuvendit.

-**“Departamenti i Buxhetit”**- do të thotë departamentin e themeluar në bazë të nenit 5 të këtij ligji;

-**“Organizatë Buxhetore”**- do të thotë një autoritet ose ndërmarrje publike e cila drejtpërdrejtë pranon një ndarje buxhetore sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore, ndarje buxhetore kjo që nuk është pjesë e një ndarje tjetër të përgjithshme buxhetore e cila i është bërë një autoriteti ose ndërmarrje tjetër publike.

-**“Zyrtari Certifikues”**- nënkupton individin në një organizatë buxhetore, agjenci autonome ekzekutive ose ndërmarrje publike i cili është punësuar në bazë të nenit 14 të këtij ligji.

-**“Zyrtari Kryesor Administrativ” ose “ZKA”**- do të thotë (i) për komunën, kryetarin e komunës, dhe (ii) për organizatat e tjera buxhetore: (a) Sekretarin e Përhershëm, (b) nëse organizata nuk ka Sekretar të Përhershëm, atëherë Kryeshefin Ekzekutiv, ose (c) nëse organizata nuk ka as Sekretar të Përhershëm dhe as Kryeshef Ekzekutiv, atëherë personin e autorizuar për administrimin e përditshëm të organizatës dhe personelit. Për agjencitë autonome ekzekutive, ZKA është drejtori ose udhëheqësi i asaj agjencie dhe jo ZKA i organizatën buxhetore pjesë e së cilës është agjencia. Për ndërmarrjet publike, ky term nënkupton Kryeshefin Ekzekutiv, drejtorin menaxhues ose personin e autorizuar për administrimin e përditshëm të veprimtarisë dhe personelit.

-**“Zyrtari Kryesor Financiar”**- nënkupton, personin brenda organizatës buxhetore, agjencisë autonome ekzekutive ose ndërmarrjes publike i cili është punësuar në këtë pozitë sipas nenit 12 të këtij ligji.

-**“Shërbyes Civil”**- ka kuptimin e përcaktuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 të 22 Dhjetorit 2001, “ mbi Shërbimin Civil në Kosovë”

-**“Detyrim Kontingjent”**- do të thotë një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen.

-**“Të ardhurat e dedikuara”**- do të thotë paratë publike që rrjedhin nga një burim i caktuar i të ardhurave dhe që me ligj ose Rregullore të UNMIK-ut kërkohet që të alokohen për një organizatë të caktuar buxhetore dhe/ose për një qëllim të caktuar; megjithatë “të ardhurat e jashtëzakonshme” nuk konsiderohen si të ardhura të dedikuara.

-**“Të ardhurat e jashtëzakonshme”**- janë të gjitha të ardhurat e një organizatë buxhetore ose autoriteti publik të cilat i atribuohen një veprimi të vetëm të një organizate buxhetore ose autoriteti publik ose një ngjarje tjetër të vetme e cila ndodh më rrallë se një herë në vit, siç mund të jetë shitja e një aseti, lëshimi i një licence, dhënia e një kontrate për koncesion, ose një rritje e përkohshme në çmimin e një burimi natyror ose malli.

-**“Njësitë e përcaktuara”**- nënkupton njësitë e përcaktuara në Listën A të këtij ligji, përveç nëse një entitet i tillë nuk privatizohet plotësisht.

-**“Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit”**- nënkupton personin e përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 4 të këtij ligji;

-**“SFQ”**- do të thotë Statistikat Financiare Qeveritare.

-**“Zyrtari Financiar”**- nënkupton dhe përfshin Zyrtarin Kryesor Administrativ, Auditorin e Brendshëm, Zyrtarin Kryesor Financiar, Zyrtarin e Prokurimit dhe Zyrtarin e Certifikimit.

-**“Viti fiskal”**- do të thotë periudhën prej 1 Janarit të një viti deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit;

- “**Grant i përgjithshëm operativ**”- do të thotë një shumë e cila i ndahet një komune dhe e cila mund të shfrytëzohet nga komuna për çfarëdo qëllimi që ndërlidhet me kompetencat e saj komunale.
- “**Qeveria**”- nënkupton Qeverinë e Republikës së Kosovës.
- “**Komisioni i Granteve**”- ka kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal.
- “**Udhëheqësi i Organizatës Buxhetore**”- nënkupton individin i cili mban pozitën më të lartë në një organizatë buxhetore;
- “**PCN**”- do të thotë Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar ose, në mungesë të tij, Kuvendi.
- “**FNK**”- do të thotë Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve.
- “**Menaxher i Investimeve**”- do të thotë çdo Menaxher të jashtëm të Investimeve të angazhuar nga Thesari në përputhje me nenin 7-të të këtij ligji.
- “**Agjenci e pavarur**”- do të thotë një autoritet publik i cili me Kushtetutë ose me një ligj se rregullore të UNMIK-ut është përcaktuar si institucion i pavarur, organ i pavarur, agjenci e pavarur, agjenci e pavarur rregullatore ose agjenci e pavarur ekzekutive.
- “**Buxheti i Konsoliduar i Kosovës**”- do të thotë buxhetin gjithëpërfshirës të Kosovës për të gjitha organizatat buxhetore.
- “**Fondi i Konsoliduar i Kosovës**”- nënkupton fondin i cili fillimisht është themeluar në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/16, (me ndryshim-plotësime), ose llogaritë apo grupin e konsoliduar të llogarive të cilat janë përcaktuar më hollësisht në Regjistrin Llogaritar të Thesarit me qëllim të depozitimit ose pagimit të parave publike, si dhe interesin e mbledhur; me kusht që ky term të mos përfshijë ndonjë grant apo donacion nga një organizatë ndërkombëtare apo qeveri e huaj, kur granti ose donacioni është objekt i kushtëzimit për mos përfshirje në Fondin e Konsoliduar të Kosovës;
- “**LFPL**”- nënkupton Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal.
- “**Ministria**”- nënkupton Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.
- “**Ministri**”- nënkupton Ministrin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.
- “**Komuna**”- do të thotë njësinë territoriale të vetëqeverisjes lokale në Kosovë e cila vepron në bazë autoritetit të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, ose cilitdo akt pasues legjislativ, dhe cilëndo njësi pasuese e vetëqeverisjes lokale në Kosovë;
- “**Kompetencat komunale**”- do të thotë kompetencat të cilat u janë dhënë komunave sipas legjisllacionit të aplikueshëm themelor mbi vetëqeverisjen lokale.
- “**Departament Komunal**”- do të thotë çdo departament në kuadër të administratës komunale.
- “**Të Ardhurat Vetanake Komunale**”- ka kuptimin e përcaktuar në LFPL.
- “**Llogari zyrtare bankare**”- do të thotë një llogari ose nën llogari bankare të krijuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit në kuadër të XHVT, me qëllim të pranimit ose trajtimit e depozitave të parave publike.
- “**Person**”- do të thotë një person fizik ose një ndërmarrje;
- “**Rregullat e KMF**”- ka kuptimin e përcaktuar në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 6 të këtij ligji.
- “**Komisioni Këshillëdhënës i KMF**”- do të thotë një komision i cili përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Departamentit të Buxhetit, Kryesuesi i Bordit për Standardet e Kontabilitetit, Ministri i Pushtetit Lokal ose

përfaqësuesi i tij/saj, Auditori i Përgjithshëm ose përfaqësuesi i tij/saj, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit si dhe Udhëheqësi i Zyrës Ligjore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

-**“Autoritet Publik”**- do të thotë secilën nga vijueset: (i) një organ, autoritet apo agjenci publike e cila në bazë të një ligji ose Rregulloreje të UNMIK-ut ushtron kompetenca ekzekutive, legjislative, rregullative, administrative-publike apo gjyqësore, dhe përfshin (ii) departamentet apo pjesët ose nën njësitë e këtij organi apo autoriteti publik;

-**“Kontratat e Ortakërisë Publiko-Private”**- do të thotë një kontratë për koncesion, sikur që është përkufizuar në Ligjin për Procedurën e Dhënies së Koncesioneve, duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse, nën-marrëveshjet dhe marrëveshjet anësore, për të cilën kërkohet përkrahje implicite ose eksplicite buxhetore. Termi “përkrahje buxhetore” do të thotë një përkrahje publike financiare ose ekonomike nga një autoritet publik në formë të një garancioni, një nxitje krediti, një kontribut të drejtpërdrejtë ose subvencion, një zotim financiar ose një pranim i një përgjegjësie kontingjente.

-**“NJOPP”**- do të thotë Njësia për Ortakëritë Publiko-Private të themeluar në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

-**“Ndërmarrje Publike”**- do të thotë (i) një njësi të përcaktuar dhe (ii) të gjithë ndërmarrjet e tjera që (a) janë në pronësi publike ose janë themeluar me fonde publike ose sipas ligjit publik, dhe (b) nuk janë autoritete publike ose pjesë të autoriteteve publike.

-**“Ndërmarrje Autonome Publike”**- do të thotë (i) të gjitha njësitë e përcaktuara, dhe (ii) të gjitha ndërmarrjet tjera publike që ushtrorë veprimtarinë e tyre me autonomi substanciale. Për qëllime të këtij neni “autonomi substanciale” konsiderohet kur ndërmarrja nuk i nënshtrohet menaxhimit të drejtpërdrejtë nga një autoritet publik; sidoqoftë, nëse menaxhmenti i ndërmarrjes publike është vetëm nën mbikëqyrje të autoritetit publik, atëherë kjo mbikëqyrje nuk konsiderohet si menaxhim i drejtpërdrejtë i ndërmarrjes publike nga autoriteti publik.

-**“Ndërmarrjet e Kontrolluara Publike”**- nënkupton të gjitha ndërmarrjet që nuk janë “ndërmarrje autonome publike”

-**“Paratë Publike”**- ka kuptimin e përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji.

-**“I emëruar i lartë publik”**- ka kuptimin e përcaktuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 të 22 Dhjetorit 2001, “mbi Shërbimin Civil të Kosovës”

-**“Thesari”**- nënkupton Departamentin e Thesarit në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji.

-**“Llogaria e Vetme e Thesarit”**- ose “LLVTH” do të thotë sistemin i cili përbëhet nga të gjitha llogaritë dhe nën-llogaritë të cilat mbahen në emër të Thesarit në AQBK ose në një bankë komerciale.

-**“Ndërmarrje”**- do të thotë çdo organ, themelatë, institucion, shoqatë, ndërmarrje, shoqëri tregtare, person juridik, ose organizatë tjetër.

1.2 “Deklarata financiare” e cila kërkohet sipas këtij ligji duhet të jetë në përputhje në baza të parave të gatshme me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik të FNK-së dhe duhet të përfshijë: (i) një Deklaratë të Konsoliduar të të Hyrave dhe Pagesave në Para të Gatshme, (ii) një Deklaratë për Krahasimin e Shumave të Pranuara dhe të Shpenzuara të Buxhetuara dhe atyre Faktike, (iii) Shënimet në Deklaratat Financiare, (iv) një Deklaratë të Aseteve në Para të Gatshme dhe Balancin e Fondeve, (v) një Deklaratë të Faturave (Detyrimeve) të papaguara, (vi) Një Deklaratë të Avanceve dhe Huave të Pa Arsyetuara, dhe (vii) një Deklaratë për Zbulimin e Aseteve Jo-Financiare dhe Detyrimeve Kontingjente. Thesari është i autorizuar që të nxjerrë udhëzime të veçanta mbi kriteret të cilat duhet të plotësohen gjatë përgatitjes së deklaratave financiare të kërkuara në bazë të këtij ligji; dhe Thesari duhet të bëjë ndryshimin e Doracakut të Kontabilitetit për t'i pasqyruar këto udhëzime.

1.3 Referencat në këtë ligj ndaj ligjeve ose rregulloreve të tjera duhet të interpretohen për të përfshirë të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ose rregulloreve të këtilla ose legjislacionin pasues të tyre.

Neni 2 Paratë publike

2.1 Në këtë ligj, “paratë publike” do të thotë paratë ose pasurinë financiare të cilat pranohen, janë nën përkujdesjen, mbahen në mirëbesim ose janë nën kontrollin e një (i) organizatë buxhetore, autoriteti publik ose ndërmarrje të kontrolluar publike, ose (ii) personi për ose në emër të cilësdo nga të sipër cekurat. Termi “para ose mjete financiare” i përmendur më sipër përfshin, por nuk kufizohet, paratë e gatshme, monedhat, barasvlerë të parave të gatshme, çeqe, note, bonde, instrumente financiare me likuiditet të lartë dhe pasuri të luajtshme financiare me likuiditet të lartë (sikur që janë gurët e çmuar ose gjysmë të çmuar ose shufrat e metaleve të çmuara).

2.2 Paratë publike përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- a) taksa, tarifa, detyrime ose tarifa për shfrytëzim;
- b) interesa, dividenda ose pagesa tjera;
- c) të ardhurat nga shitja, qiradhënia ose qiramarrja e çfarëdo prone;
- d) tarifat rregullative, tarifat e licencimit si dhe tarifat dhe taksat e ngjashme;
- e) pagesat, tarifat dhe taksat për ofrimin e shërbimeve, furnizimin e mallrave ose kryerjen e punëve;
- f) të ardhurat e pranuar ose të cilat janë realizuar drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë nga dhënia e lejeve ose nga shitja e cilësdo të drejtë mbi një burim publik, duke përfshirë - por pa u kufizuar në - të drejtën ndaj brezit frekuencor, të drejtën e shfrytëzimit të tokës, të drejtat për eksplorimin ose eksploatimin e pasurive natyrore ose të drejtat e shfrytëzimit, si dhe të drejtat mbi pronën intelektuale;
- g) rentat;
- h) depozitat e sigurimit dhe të kushtëzimit;
- i) gjobat, kompensimet e dëmit nga paditë civile, dhe të ardhurat nga sigurimi; dhe
- j) grantet dhe donacionet nga organizatat ndërkombëtare, Qeveritë e huaja ose cilido burim tjetër.

2.3 Të gjitha paratë publike duhet të depozitohen në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në pajtim me Rregullat e KMF dhe paratë publike mund të shfrytëzohen ose shpenzohen vetëm pasi që të jenë ndarë në mënyrë të rregullt sipas këtij ligji.

2.4 Të gjitha transaksionet me fonde brenda FKK duhet të bëhen përmes LLVTH.

2.5 Paragrafi 3 i këtij neni duhet të respektohet rreptësisht nga të gjithë personat, organizatat buxhetore, autoritetet publike dhe ndërmarrjet publike. Në rast të konfliktit ndërmjet paragrafit 3 të këtij neni dhe një dispozite të një ligji, rregullore, ose akti tjetër ligjor ose nën-ligjor, paragrafi 3 i këtij neni mbisundon; megjithatë, mjetet nga ndihma financiare për një komunë nga Republika e Serbisë mund të depozitohen në një bankë komerciale sikur që është përcaktuar në LFPL.

2.6 Përrjashtimisht, nëse një dispozitë e një ligji ose rregullore të UNMIK-ut krijon ose autorizon krijimin e një fondi të veçantë ose ndonjë fondi për qëllim të caktuar për çfarëdo artikulli të parasë publike, ky fond duhet të krijohet në formë të llogarisë së ndarë ose nën-llogarisë në kuadër të Fondit të Konsoliduar të Kosovës, dhe paratë publike të cilat mbahen në këtë llogari i nënshtrohen plotësisht paragrafit 3 të këtij neni. Dispozitat në aktet ligjore ose nën-ligjore, përveç një ligji ose Rregullore të UNMIK-ut, që krijojnë ose autorizojnë krijimin e një fondi të këtillë janë të paligjshme, nule dhe nuk prodhojnë efekte juridike.

2.7 Si një përjashtim i kufizuar i paragrafit 3 të këtij neni për ato artikuj të parasë publike në të cilat pagesi ose dërguesi posedon të drejtën e kthimit (sikur që janë depozitat e sigurisë dhe ato të kushtëzimit) Thesari do të përgatisë rregulla të veçanta - në pajtim me kërkesat e tjera të zbatueshme ligjore – për trajtimin dhe kthimin e këtyre artikujve të parasë publike.

2.8 Pavarësisht nga dispozitat kundërtënëse në këtë nen, shprehimisht përcaktohet se paratë dhe pasuria financiare që mbahet në mirëbesim nga AKM-ja ose TKPK sipas një ligji ose Rregullore të UNMIK-ut nuk janë “para publike.”

Neni 3 **Ekzekutimi i kërkesave dhe detyrimeve**

Të gjitha autoritetet publike, organizatat buxhetore dhe ndërmarrjet publike, gjatë ushtrimit të një aktiviteti ose pranimi të një detyrimi që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë përfshin ose ndikon në shfrytëzimin e parave ose burimeve publike, duhet të veprojnë në përputhje të plotë me dispozitat e këtij ligji. Asnjë detyrim që është rezultat i një dokumenti, marrëveshje apo aranzhimi nuk zbatohet nëse dokumenti, marrëveshja ose aranzhimi i këtitllë që themelon apo rezulton në lindjen e këtij detyrimi është përpiluar, pranuar apo lidhur në një mënyrë që nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji.

PJESA II **Zyrtarët dhe Institucionet për Menaxhimin e Financave Publike**

KREU I **Zyrtarët dhe Institucionet në Ministri**

Neni 4 **Departamenti i Thesarit**

4.1 Departamenti i Thesarit (“Thesari”) themelohet në kuadër të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa dhe është përgjegjës për menaxhimin e Fondit të Konsoliduar të Kosovës si dhe për përmbushjen e të gjitha përgjegjësiave të cilat i janë dhënë në bazë të këtij ligji.

4.2 Thesari vepron me autonomi substanciale dhe është përgjegjës për organizimin dhe personelin e vet, duke përfshirë punësimin e Zyrtarëve të vet Financiar. Pavarësisht nga e mësipërmja, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit:

- a) duhet të sigurojë që politikat administrative, operacionale dhe ato të personelit të Thesarit jenë në përputhje me politikat të cilat janë në fuqi në Ministri,
- b) do të koordinojë me ZKA-në e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për të siguruar që raportet dhe dërgesat administrative, që kërkohen nga Ministria në lidhje me aktivitetet e Thesarit, duke përfshirë edhe raportet vjetore, të jenë të kompletuara; dhe
- c) mund të lidhë një marrëveshje me ZKA të Ministrisë lidhur me ndarjen e shërbimeve të ZKF, Zyrtarit të Prokurimit, Auditorit të Brendshëm dhe/ose Zyrtarit Certifikues të Ministrisë; dhe

4.3 Thesari duhet të përgatisë raporte të hollësishme tremujore në lidhje me veprimtarinë e tij për Ministrin. Thesari po ashtu duhet që menjëherë të përgjigjet në cilëndo kërkesë specifike të Ministrin lidhur me informata për ndonjë çështje që ka të bëjnë me fushëveprimin e tij.

4.4 Do të konsiderohet si shkelje e këtij ligji nëse cilido person ushtron ose tenton të ushtrojë ndikim politik ose administrativ ose ndikim tjetër në Thesarit ose në personelin ose në personelin udhëheqës të tij; me kusht që kjo ndalesë nuk do vlejë për komunikatat ose përpjekjet e bëra me qëllim të nxitjes së zbatimit të këtij ligji ose një ligji tjetër nga ana e Thesarit.

4.5 Thesari udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm. Ministri është i autorizuar që ta emërojë Drejtorin e Përgjithshëm, pas marrjes së pëlqimit me shkrim nga PCN. Që të dytë, edhe Ministri dhe PCN duhet që së pari të sigurojnë që personi përkatës (i) të ketë përvojë të konsiderueshme në veprimtari bankare dhe/ose të pagesave financiare dhe (ii) të mos jetë dënuar për vepër penale, (iii) të mos ushtrojë ndonjë

post udhëheqës ose post tjetër domethënës në ndonjë parti politike, dhe (iv) të posedojë karakter të përshtatshëm moral dhe përvojë profesionale.

4.6 Mandati i Drejtorit të Përgjithshëm është pesë vjet. Drejtori i Përgjithshëm mund të ri-emërohet për një ose më shumë mandate pesë vjeçare shtesë. Ministri mundet, pas pëlqimit me shkrim të PCN, ta shkarkojë Drejtorin e Përgjithshëm nga ky post para skadimit të mandatit pesë vjeçar, vetëm nëse ka arsye të mira dhe të justifikueshme, të cilat mund të përfshijnë cilëndo nga të mëposhtmet:

- a) drejtori i Përgjithshëm në mënyrë të vazhdueshme tregon se atij/asaj i mungon kompetenca e domosdoshme për të administruar në mënyrë profesionale me Thesarin dhe veprimtarinë e tij;
- b) drejtori i Përgjithshëm ka dështuar në ushtrimin e kujdesit të arsyeshëm profesional për të siguruar që veprimet e tij/saj dhe veprimet e personelit të Thesarit janë në përputhje dhe të autorizuara me ligj;
- c) drejtori i Përgjithshëm në mënyrë të vazhdueshme ka dështuar që ti përmbushë detyrimet e tij/saj sipas pikave a) dhe/ose b) të paragrafit 2 të këtij neni; ose
- d) drejtori i Përgjithshëm është angazhuar në vepra të cilat përfshijnë konflikt të interesave; ose
- e) drejtori i Përgjithshëm ka lejuar që personeli i Thesarit të angazhohet në një vepër për të cilën Drejtori i Përgjithshëm ka qenë në dijeni se përfshin konflikt të interesave, ose për cilën Drejtori i Përgjithshëm, përmes ushtrimit të përkujdesjes të arsyeshme menaxheriale, është dashur të dijë se përfshin konflikt të interesave.

4.7 Nëse Ministri, pas pranimi të pëlqimit nga PCN, e ushtron të drejtën e tij/saj për shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm, Ministri duhet t'i dorëzojë Drejtorit të Përgjithshëm një deklaratë me shkrim në të cilën duhet të theksohen arsyet e shkarkimit së bashku me një kopje të pëlqimit të PCN për shkarkimin. Nëse personi i shkarkuar konsideron se shkarkimi nuk ka bazë të arsyetueshme juridike, ky person mund t'i drejtohet gjykatës kompetente me qëllim të shqyrtimit të këtij rasti; dhe gjykata është e autorizuar që të marrë çfarëdo masa të cilat i konsideron të ligjshme dhe adekuate.

4.8 Drejtori i Përgjithshëm (i) nuk do të angazhohet në aktivitete politike dhe duhet të jetë i paanshëm në të gjitha çështjet politike, (ii) është i emëruar i lartë publik; megjithatë, rregullat për emërimin dhe largimin e tij janë ato që janë përcaktuara me këtë Nen 4.

4.9 Drejtori i Përgjithshëm është i detyruar që në bazë vjetore, t'i dorëzojë Ministrit, Kuvendit, Qeverisë, komunave dhe PCN një raport vjetor mbi të gjitha çështjet që ndërlidhen me veprimtarinë e Thesarit si dhe zbatimin e Rregullave KMF dhe Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Ky raport duhet të përmbajë një dispozitë (i) në të cilën përshkruhen problemet kryesore në veprimtarinë e Thesarit, zbatimin e Rregullave KMF dhe Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, dhe (ii) në të cilën Drejtori i Përgjithshëm jep rekomandime për zgjidhjet e mundshme të këtyre problemeve.

4.10 Përveç raportit vjetor të përcaktuar në paragrafin 9 të këtij neni, Drejtori i Përgjithshëm, kurdo që has në probleme të konsiderueshme të cilat ndikojnë në veprimtarinë e Thesarit, menjëherë duhet t'i raportojë personave dhe institucioneve të përcaktuara në paragrafin 9 të këtij neni.

Neni 5 **Departamenti i Buxhetit**

5.1 Në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave themelohet Departamenti i Buxhetit. Departamenti i Buxhetit udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili është i emëruar i lartë publik. Departamenti i Buxhetit përbëhet nga dy njësi të veçanta: (i) njësia e buxhetit qendror, dhe (ii) njësia e buxhetit komunal. Secila nga këto njësi udhëhiqen nga një i emëruar i lartë publik.

5.2 Përveç nëse përcaktohet ndryshe nga Ministri, njësia e buxhetit qendror pranë Departamentit të Buxhetit është e autorizuar dhe përgjegjëse për (i) përgatitjen e Propozim Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, (ii) përgatitjen e Kornizës Afat Mesme të Shpenzimeve, (iii) zbatimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, (iv) vlerësimin e kërkesave për ndryshimin e ndarjeve buxhetore, dhe (v) ushtrimin e të gjitha përgjegjësisive të tjera të cilat i janë dhënë Departamentit të Buxhetit me këtë ligj.

5.3 Përveç nëse përcaktohet ndryshe nga Ministri, njësia e buxhetit komunal pranë Departamentit të Buxhetit është e autorizuar dhe përgjegjëse për (i) përmbushjen e detyrimeve të tyre buxhetore të cilat u janë ngarkuar atyre në bazë të këtij ligji, dhe (ii) ushtrimin e të gjitha përgjegjësive të tjera të cilat i janë dhënë Departamentit të Buxhetit me këtë ligj.

Neni 6 **Departamentet dhe njësitë e tjera**

6.1 Në kuadër të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa të themelohet Departamenti i Politikave Ekonomike. Departamenti i politikave ekonomike është përgjegjës për përpilimin e parashikimeve makroekonomike dhe fiskale si dhe përcaktimin e parametrave të përgjithshëm të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe politikave afatmesme buxhetore. Departamenti i Politikave Ekonomike po ashtu mundet të bëjë analiza për rrezikun fiskal si dhe planifikojë skenarë nën programe të mëdha ta parashikimit.

6.2 Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (NJQH për Auditim të Brendshëm) do të themelohet në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave në pajtim me Ligjin për Auditimin e Brendshëm. Po ashtu, Ministria do të ketë Njësinë e saj të Auditimit të Brendshëm ose Auditorin e Brendshëm, e cila është e ndarë dhe e veçantë nga NJQH për Auditimin e Brendshëm, sipas nenit 11 të këtij ligji dhe Ligjit për Auditimin e Brendshëm.

6.3 Ministria do të themelojë Njësinë Qendrore për Harmonizimin e Kontrollit Financiar (NJQH për kontrollin financiar) e cila do të përgatisë dhe do t'i sigurojë Ministrit një propozim-përmbledhje të hollësishme të Rregullave për Kontrollin dhe Menaxhimin Financiar ("Rregullat KMF") të cilat e themelojnë një sistem të rregullave për kontrollin dhe menaxhimin financiar për sektorin publik si dhe operimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontabilitetit. Rregullat KMF, ndër tjera, do të parashtrajnë në hollësi rregullat dhe procedurat e detyrueshme të cilat duhet të respektohen nga autoritetet publike, personat ose ndërmarrjet gjatë pranimit, trajtimit, bartjes, shpenzimit ose shkarkimit të parave publike. Rregullat KMF duhet të jenë në përputhje me (i) parimet e kontrollit të brendshëm të financiar publik të themeluara nga KE, (ii) standardet ndërkombëtar të kontabilitetit në sektorin publik të FNK-së, dhe (iii) dispozitat e këtij ligji, Ligjit për Prokurim Publik si dhe të gjitha ligjeve të tjera në Kosovë të cilët i rregullojnë këto çështje.

6.4 Rregullat KMF shpallen nga Ministri, ai/ajo është i autorizuar që para shpalljes së tyre të modifikojë draft-Rregullat KMF të pranuar nga NJQH për Kontrollin Financiar ashtu si Ministri e konsideron të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me pikat e paragrafit 3 të këtij neni,

6.5 NJQH për Kontrollin Financiar në mënyrë rregullon kërkon këshilla dhe komente nga Komisioni Këshillëdhënës i KMF në lidhje me përpilimin dhe zbatimin e Rregullave KMF si dhe në lidhje me çfarëdo propozim-modifikimi të tyre. NJQH për Kontrollin Financiar është e autorizuar dhe përgjegjëse për trajnimin si dhe këshillimin dhe ofrimin e ndihmës së vazhdueshme për të gjithë personat përkatës në lidhje me përmbajtjen dhe zbatimin e rregullit të Rregullave KMF.

6.6 Ministria ka autorizimin dhe përgjegjësinë për trajnimin, këshillimin dhe dhënien e ndihmës së vazhdueshme për të gjithë personat përkatës në lidhje me përmbajtjen dhe zbatimin e rregullit të Rregullave KMF.

6.7 Në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave themelohet Njësia për Ortakërinë Publiko-Private (NJOPP). NJOPP është njësi këshillëdhënëse e cila shërben si qendër e ekspertizës dhe është përgjegjëse për vlerësimin dhe këshillimin dhe përkrahjen e Ministrit dhe autoriteteve të tjera kontraktuese lidhur me Kontratat e propozuara të Ortakërisë Publiko-Private si dhe për ushtrimin e të gjitha funksioneve të tjera të dhëna me ligj.

6.8 Ministri është i autorizuar që të themelojë departamente ose njësi të tjera në kuadër të Ministrisë, si dhe që t'i ndajë përgjegjësitë ndërmjet departamenteve dhe njësive të Ministrisë, ashtu siç është e arsyeshme për të ndihmuar Ministrinë në përmbushjen e detyrave dhe ushtrimin e funksioneve të cilat i

janë dhënë asaj sipas këtij ligji ose një ligji tjetër; me kusht që, përgjegjësitë dhe funksionet të cilat i janë dhënë Thesarit sipas këtij ligji nuk mund të ndahen.

Neni 7 **Menaxheri i investimeve**

7.1 Ministri mund t'ia bartë përgjegjësinë për bërjen dhe menaxhimin e Investimeve të Autorizuara (i) AQBK-së, (ii) shërbyesve profesional civil të punësuar nga thesari për këtë qëllim, ose (iii) një menaxheri të jashtëm të investimeve të angazhuar për këtë qëllim. Cilido person ose institucion i këtillë (i) duhet t'i bëjë dhe t'i menaxhojë Investimet e Autorizuara në përputhje të plotë me nenet 8 dhe 9 të këtij ligji dhe (ii) i nënshtrohet drejtitimit dhe kontrollimit nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit. Kur Ministri vendos të angazhojë një Menaxher të Jashtëm të Investimeve, atëherë zbatohen paragrafët 2 dhe 4 të këtij neni.

7.2 Nëse Ministri vendos që të angazhojë një Menaxher të Jashtëm të Investimeve, procesi i tenderimit për Menaxherin e Investimeve duhet të jetë në përputhje të plotë me Ligjin për Prokurim Publik. Vetëm subjektet në vijim kanë të drejtë të paraqesin tender (i) një bankë e klasifikuar AA nga një agjenci e mirënjohur ndërkombëtare e klasifikimit, (ii) një bankë e investimeve me klasifikim të ngjashëm, dhe (iii) një kompani për menaxhim financiar e cila posedon një klasifikim të ngjashëm ose e cila demonstroi kualifikime të ngjashme. Nga çdo tenderues do të kërkohet të paraqesë një konfirmim me shkrim që pranimiti i pozitës së Menaxherit për Investime nuk do të krijojë asnjë konflikt interesi.

7.3 Zyrtari i Prokurimit i Thesarit duhet të sigurojë që në kushtet e kontratës me Menaxherin e Investimeve (i) të përcaktohen në hollësi çështja e kompensimit; (ii) të detyrohet Menaxheri i Investimeve që të përfshijë së paku (3) shërbyes civil të Thesarit në aktivitetet e Menaxherit të Investimeve si dhe t'u ofrojë këtyre shërbyesve civil trajnim të vazhdueshëm profesional në fushën e menaxhimit të investimeve; dhe (iii) t'i lejohet Thesarit që ta ndërpresë kontratën, me apo pa arsye, tridhjetë (30) ditë pas paralajmërimit më shkrim.

7.4 Nëse në çdo kohë, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit konstaton se Thesari ka shërbyes civil të trajnuar të cilët janë në gjendje që të kryejnë shërbimet për menaxhimin e investimeve, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit mund t'ua caktojë përgjegjësinë për menaxhimin e investimeve këtyre shërbyesve civil në vend të angazhimit të një menaxheri të jashtëm të investimeve sipas dispozitave të mësipërme të këtij neni. Në këto raste, Ministria e ushtron të drejtën e saj për ndërprerjen e kontratës për menaxhimin e investimeve në pajtim me kushtet e kësaj kontrate.

Neni 8 **Autorizimi për Investimin e Parave Publike**

Thesari ka autorizimin dhe përgjegjësinë ekskluzive për investimin e parave publike. Pavarësisht nga kjo, Ministri (i) përcakton kushtet për investimin e parave publike dhe aktivitetet e investimeve të Thesarit, dhe (ii) përgatit politikën për investimin e parave publike. Kjo politikë e investimeve trajton rreziqet të cilat ndërliqhen me kundër palët dhe shtetet e caktuara dhe duhet të përfshijë dispozita për themelimin e një komisioni të investimeve.

Neni 9 **Investimi i FKK**

9.1 Fondet nga FKK mund të investohen vetëm në një ose më shumë Investime të Autorizuara, dhe duhet të bëhen ekskluzivisht në si vijon:

- a) një llogari ekzistuese interesi në AQBK;
- b) një depozitë me afat kohor në AQBK;
- c) një fond tregtar nëse (a) fondi i nënshtrohet rregullave dhe rregulloreve të Komisionit të SHBA-së për Letra me Vlerë dhe Këmbime ose të një Institucioni Mbikëqyrës të BE-së, dhe (b) portofoli i fondit përbëhet vetëm nga letra me vlerë të emërtuara në Euro;

- d) një bond ose një sigurim tjetër për borxhin i cili është lëshuar ose është garantuar nga Shtetet e Bashkuara ose një shtet anëtar i BE-së dhe i cili është klasifikuar së paku me “A” nga një agjenci e mirënjohur ndërkombëtare e klasifikimit;
- e) një depozitë në cilëndo bankë komerciale në Kosovë e cila është e siguruar me depozit të sigurimit në AQBK nëse (i) kjo bankë është klasifikuar me së paku “A” ose (ii) shumica e aksionarëve të saj janë klasifikuar së paku me “A”;
- f) një depozitë në cilëndo bankë të huaj e cila është e organizuar në përputhje me ligjet e një shteti anëtar të BE-së dhe e cila është klasifikuar së paku me “A” nga një agjenci e mirënjohur ndërkombëtare e klasifikimit; dhe/ose
- g) një marrëveshje të ri-blerjes në bazë të së cilës letrat e blera me vlerë përbëhen vetëm nga bonde ose letra të tjera me vlerë të përcaktuara në pikën (iii) më sipër dhe të cilat mbahen nga një palë e tretë kujdestare.

9.2 Data e maturimit për një Investim të Autorizuar nuk mund të jetë më vonë se koha kur paratë publike të investuara pritet se do të nevojiten për të financuar një ndarje buxhetore.

9.3 Secili Investim i Autorizuar duhet të mbahet në një llogari të veçantë të mirëbesimit ose në bazë të një marrëveshje kujdestarie me një palë të tretë në emër ose në të mirë të Ministrisë.

9.4 Së paku dhjetë për qind (10%) e parave të investuara publike duhet të investohen në një ose më shumë Investime të Autorizuara me likuiditet të lartë, që do të thotë një Investim i Autorizuar i cili mund të likuidohet në bazë të kërkesës dhe pa dënim ose i cili ka afat të maturimit i cili nuk është më shumë se shtatë (7) vite.

9.5 Të gjitha fondet, duke përfshirë shumën kapitale dhe interesin e mbledhur, të pranuar nga likuidimi i një investimi të parave publike do të depozitohen në Fondin e Konsoliduar të Kosovës.

9.6 Interesi tjetër i mbledhur nga një investim i parave publike do të depozitohet në Fondin e Konsoliduar të Kosovës, përveç nëse në kushtet e investimit themelor është përcaktuar se interesi do t'i shtohet investimit themelor.

KREU II

Zyrtarët Financiar të Organizatës Buxhetore, Agjencisë Autonome Ekzekutive dhe Ndërmarrjes Publike

Neni 10

Zyrtari Kryesor Administrativ

10.1 Zyrtari Kryesor Administrativ ka përgjegjësinë kryesore ligjore për të siguruar që organizata buxhetore, agjencia autonome ekzekutive ose ndërmarrja publike dhe personeli i saj të jenë në përputhshmëri të plotë si dhe të respektojnë dispozitat e zbatueshme të këtij ligji dhe Rregullat KMF.

10.2 Zyrtari Kryesor Administrativ, ndër tjera, është shprehimisht përgjegjës për:

- a) vendosjen e kontrollit të brendshëm në organizatën buxhetore, agjencinë autonome ekzekutive ose ndërmarrjen publike sipas Rregullave KMF;
- b) delegimin e funksioneve për mbledhjen dhe shpenzimin e parave publike në pajtim me Rregullave KMF;
- c) vendosjen e një kornize për vlerësimin dhe menaxhimin e përformansës së personelit të organizatës buxhetore të cilëve u janë deleguar funksionet e tilla;
- d) vendosjen dhe zbatimin e masave të brendshme disiplinore për tu zbatuar në raste kur personeli nuk i ushtron funksionet e deleguara në mënyrë adekuate apo të rregullt; dhe
- e) njoftimin e Auditorit të Përgjithshëm për të gjitha rastet ku me arsye dyshohet se ka pasur shkelje – nga një person ose ndërmarrje – të këtij ligji, Rregullave KMF ose ndonjë ligji tjetër.

10.3 Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme, asnjë dispozitë e këtij neni nuk mund të interpretohet ose zbatohet në një mënyrë që e autorizon Zyrtarin Kryesor Administrativ që të ndërhyjë gjatë ushtrimit të detyrave të ligjshme të zyrtarëve financiar të cilat u janë dhënë këtyre të fundit sipas këtij ligji, Rregullave KMF ose ndonjë ligji tjetër.

Neni 11 Auditori i Brendshëm

11.1 Të gjitha organizatat buxhetore, agjencitë autonome ekzekutive dhe ndërmarrjet publike duhet t'i përmbushin të gjitha kushtet e përcaktuara në Ligjin për Auditimin e Brendshëm, duke përfshirë dispozitat të cilat kërkojnë themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ose prokurimin e shërbimeve të një Auditori të Brendshëm.

11.2 Pavarësisht nga e sipër cekura, (i) ZKA i një ndërmarrje të kontrolluar publike mund të lidhë marrëveshje me ZKA-në e organizatës kontrolluese buxhetore për ndarjen e shërbimeve të një Auditori të vetëm të Brendshëm, dhe (ii) ZKA i një agjencie autonome ekzekutive mund të lidhë marrëveshje me ZKA-në e organizatës buxhetore pjesë e së cilës është agjencia, për ndarjen e shërbimeve të një Auditori të vetëm të Brendshëm.

11.3 Kërkesat e përcaktuara në Ligjin për Auditimin e Brendshëm nga këtu e tutje vlejnë edhe për agjencitë autonome ekzekutive. Agjencitë autonome ekzekutive duhet të përmbushin këto kushte njëjloj sikurse edhe organizatat e tjera buxhetore.

11.4 Nëse Auditori i Brendshëm është punonjës i organizatës buxhetore apo agjencisë autonome ekzekutive, ai/ajo ka statusin e shërbyesit civil.

11.5 Çdo Auditor i Brendshëm që vepron në kuadër të Njesisë së Auditimit të Brendshëm apo që ofron shërbime të auditimit të brendshëm konsiderohet "zyrtar financiar" i organizatës përkatëse buxhetore, agjencisë autonome ekzekutive apo ndërmarrjes publike.

Neni 12 Zyrtari Kryesor Financiar

12.1 Çdo organizatë buxhetore, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarrje publike duhet ta ketë Zyrtarin Kryesor Financiar.

12.2 Pavarësisht nga e sipër cekura, (i) ZKA i një ndërmarrje të kontrolluar publike mund të lidhë marrëveshje me ZKA-në e organizatës kontrolluese buxhetore për ndarjen e shërbimeve të një ZKF të vetëm, dhe (ii) ZKA i një agjencie autonome ekzekutive mund të lidhë marrëveshje me ZKA-në e organizatës buxhetore pjesë e së cilës është agjencia, për ndarjen e shërbimeve të një ZKF të vetëm.

12.3 Përveç në rastin e Zyrtarit Kryesor Financiar të ndërmarrjes publike, ZKF ka statusin e shërbyesit civil.

12.4 Çdo ZKF është përgjegjës për veprimtarinë e rregullt dhe të ligjshme financiare të organizatës përkatëse buxhetore, agjencisë autonome ekzekutive ose ndërmarrjes publike.

12.5 Për organizatën buxhetore ose agjencinë autonome ekzekutive, ZKF është i autorizuar dhe përgjegjës për: (i) përgatitjen e propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore të organizatës përkatëse buxhetore apo agjencisë autonome ekzekutive; (ii) të sigurojë që të gjitha transaksionet të regjistrohen në Regjistrin e Kontabilitetit të Thesarit; (iii) të sigurojë që të gjitha faturat e rregullta të pranuar nga organizata buxhetore të dorëzohen menjëherë për pagim përmes sistemit të thesarit; (iv) mbikëqyrjen e të gjitha aspekteve të raportimit buxhetor nga ana e organizatës buxhetore; dhe (v)

ushtrimin e të gjitha funksioneve që i janë dhënë ZKF-së sipas Rregullave KMF. Të gjitha detyrat e ZKF-së duhet të jenë në përputhje të plotë me Rregullat KMF.

Neni 13 Zyrtari i Prokurimit

13.1 Çdo organizatë buxhetore, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarrje publike duhet të ketë një Zyrtar të Prokurimit, i cili është përgjegjës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit të organizatës buxhetore në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik.

13.2 Një person mund të shërbejë në cilësinë e Zyrtarit të Prokurimit vetëm nëse posedon një "Certifikatë Profesionale të Prokurimit" aktuale dhe të vlefshme të lëshuar sipas Ligjit për Prokurim Publik.

13.3 Pavarësisht nga e sipër cekura, (i) ZKA i një ndërmarrje të kontrolluar publike mund të lidhë marrëveshje me ZKA-në e organizatës kontrolluese buxhetore për ndarjen e shërbimeve të Zyrtarit të Prokurimit të organizatës buxhetore, dhe (ii) ZKA i një agjencie autonome ekzekutive mund të lidhë marrëveshje me ZKA-në e organizatës buxhetore pjesë e së cilës është agjencia, për ndarjen e shërbimeve të Zyrtarit të Prokurimit të organizatës buxhetore.

13.4 Përveç në rastin e Zyrtarit të Prokurimit të ndërmarrjes publike, Zyrtari i Prokurimit mban statusin e shërbyesit civil.

Neni 14 Zyrtari Certifikues

14.1 Çdo organizatë buxhetore, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarrje publike duhet të ketë Zyrtarin Certifikues. Zyrtari Certifikues emërohet dhe i raporton Zyrtarit Kryesor Administrativ.

14.2 Pavarësisht nga e sipër cekura, (i) ZKA i një ndërmarrje të kontrolluar publike mund të lidhë marrëveshje me ZKA-në e organizatës kontrolluese buxhetore për ndarjen e shërbimeve të një Zyrtari të vetëm Certifikues, dhe (ii) ZKA i një agjencie autonome ekzekutive mund të lidhë marrëveshje me ZKA-në e organizatës buxhetore pjesë e së cilës është agjencia, për ndarjen e shërbimeve të një Zyrtari të vetëm Certifikues.

14.3 Përveç në rastin e Zyrtarit Certifikues të ndërmarrjes publike, Zyrtari Certifikues mban statusin e shërbyesit civil.

14.4 Zyrtari Certifikues është përgjegjës që a) të sigurojë që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës, b) të sigurojë që shpenzimi i parave publike sipas një kontrate publike të bëhet në pajtim me Rregullat e KMF. Zyrtari Certifikues po ashtu ushtron të gjitha detyrat të cilat i janë caktuar atij/asaj sipas Rregullave KMF.

14.5 Zyrtari Certifikues duhet që të identifikojë dhe menjëherë t'i raportojë me shkrim Zyrtarit Kryesor Administrativ, ZKF dhe cilitdo zyrtar tjetër të rangut të lartë në organizatën buxhetore, agjencinë autonome publike ose ndërmarrjen publike mbi të gjitha rastet e mos-respektimit të këtij ligji. Rastet e mos-respektimit të Ligjit mbi Prokurimin Publik gjithashtu duhet t'i raportohen Auditorit të Përgjithshëm. Zyrtari Certifikues mban shënime gjithëpërfshirëse me shkrim mbi të gjitha rastet e mos-respektimit të ligjit për së paku shtatë (7) vite.

Neni 15 Punësimi ose Angazhimi i Zyrtarëve Financiar

15.1 Në rast se një pozitë për Zyrtar Financiar lirohet, ajo duhet të plotësohet brenda nëntëdhjetë (90) ditëve.

15.2 Asnjë person nuk mund të mbajë më shumë se një pozitë të Zyrtarit Financiar në një organizatë buxhetore.

PJESA III Mbledhja dhe ruajtja e parave publike

Neni 16 Pranimi i parave publike

16.1 Asnjë autoritet publik, person ose ndërmarrje nuk do të pranojë para publike, përveç nëse autorizohet shprehimisht në bazë të një ligji ose Rregullore të UNMIK-ut ose me shkrim nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit.

16.2 Të gjitha të ardhurat e një autoriteti publik ose ndërmarrje të kontrolluar publike depozitohen në një llogari zyrtare bankare në pajtim me Rregullat KMF; megjithatë, mjetet nga ndihma financiare për një komunë nga Republika e Serbisë mund të depozitohet në një bankë komerciale sikur që është përcaktuar në LFPL.

16.3 Të gjitha paratë publike (përfshirë këtu edhe ato para që pas pranimit shndërrohen në para publike) menjëherë depozitohen në një llogari zyrtare bankare të krijuar ose të përcaktuar nga Thesari. Depozitimi i parave publike bëhet në pajtim me Rregullat KMF.

Neni 17 Shpenzimi i parave publike

17.1 Paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike. Asnjë autoritet publik, organizatë buxhetore, person apo ndërmarrje nuk mund të devijojnë, keq zbatojnë, ekspozojnë apo të përdorin në mënyrë të pa rregullt paratë publike.

17.2 Shpenzimi i parave publike mund të bëhet vetëm nga fondet e ndara dhe të alokuara dhe vetëm në përputhje me procesin i cili është themeluar nga Rregullat KMF sipas paragrafit 2 të nenit 38 të këtij ligji.

Neni 18 Llogaritë në Fondin e Konsoliduar të Kosovës

18.1 Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit është i autorizuar që të krijojë dhe mbajë llogaritë dhe nën-llogaritë për fondet brenda Fondit të Konsoliduar të Kosovës siç e sheh të arsyeshme për zbatimin e dispozitave të këtij ligji. Nën-llogari të veçanta do të krijohen për të ardhurat vetanake të secilës komunë. Të gjitha llogaritë dhe nën-llogaritë e sipër cekura do të jenë pjesë e LLVTH. Të gjitha pagesat dhe shpenzimet e parave publike duhet të bëhen përmes LLVTH.

18.2 Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit i krijon llogaritë dhe nën-llogaritë të cilat e përbëjnë LLVTH në AQBK ose, nëse Drejtori i Përgjithshëm nuk është në gjendje që ta bëjë këtë, në një bankë e cila përzgjidhet përmes një procesi të tenderimit i cili duhet të ushtrohet në pajtim me Ligjin për Prokurim Publik; me kusht që vetëm bankat të cilat i përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën (e) ose (f) të paragrafit 1 të nenit 9 të këtij ligji të kenë të drejtë të paraqesin tender.

18.3 Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit është shprehimisht i autorizuar që të krijojë dhe mbajë llogari në mirëbesim për trajtimin e parave publike të cilat do të mbahen në mirëbesim.

18.4 Marrëdhënia ndërmjet AQBK-së dhe Thesarit do të elaborohet në një marrëveshje ndër-institucionale në të cilën përcaktohen përgjegjësitë e AQBK në lidhje me administrimin e LLVTH si dhe menaxhimin e FKK-së.

PJESA IV **Përgatitja dhe Përmbajtja e Propozim-Buxhetit Vjetor të Konsoliduar të Kosovës**

Neni 19 **Përgatitja e Kornizës Afat Mesme të Shpenzimeve**

19.1 Sa më shpejt që të jetë praktike gjatë vitit fiskal 2008, dhe jo më vonë se deri me 30 prill duke filluar nga viti fiskal 2009, Qeveria duhet t'ia dorëzojë Kuvendit Kornizën Afat Mesme të Shpenzimeve (KAMSH) për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësimet për dy vitet e ardhshme fiskale ("Periudha Buxhetore e KAMSH"). KAMSH përmban:

- a) parashikime makro ekonomike dhe fiskale për Periudhën Buxhetore të KAMSH, të cilat përfshijnë treguesit kryesor ekonomik si inflacioni, BPV dhe kurset e këmbimit;
- b) një analizë të tendencave për alokimin e burimeve financiare dhe një analizë të shpenzimeve buxhetore sipas kategorive kryesore ekonomike;
- c) parashikime të borxhit vendor për Periudhën Buxhetore të KAMSH;
- d) një vlerësim të burimeve të nevojshme për kthimin e borxheve të brendshme dhe të jashtme gjatë Periudhës Buxhetore të KAMSH;
- e) një analizë të tendencave të investimeve kapitale të cilat financohen nga buxheti si dhe një vlerësim të volumit të tyre për Periudhën Buxhetore të KAMSH;
- f) një rishikim të politikës së pagave për Periudhën Buxhetore të KAMSH;
- g) një analizë të tendencave të punësimit dhe përpjesëtimi i pagave në sektorin buxhetor si dhe një vlerësim të ndikimit të një politike për reformimin e pagave;
- h) një propozim për përshtatjen e politikës së përpjesëtimit të pagave me kornizën makro-fiskale të përcaktuar në KAMSH me qëllim të sigurimit të përkrahjes përkatëse financiare;
- i) tavanet e vlerësuara të shpenzimit për secilën organizatë buxhetore e cila nuk është komunë ose agjenci e pavarur me të ardhura të dedikuara;
- j) nivelet e vlerësuara të granteve për secilën komunë, të llogaritura sipas formulës së përcaktuar në LFPL;
- k) çfarëdo informata të tjera të cilat Ministri dëshiron t'i përfshijë.

19.2 Ministri do ta azhurnojë KAMSH-in para dorëzimit së bashku me BKK-në deri në datën e përcaktuar në paragrafit 1 të nenit 22 të këtij ligji.

Neni 20 **Përgatitja dhe rishqyrtimi i propozim-buxheteve dhe kërkesave për ndarje buxhetore**

20.1 Në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, Ministri është i autorizuar dhe përgjegjës që të nxjerrë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore, me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

20.2 Në ose para datës së caktuar në paragrafin 3 të këtij neni, Ministri duhet t'u dërgojë Zyrtarëve Kryesor Financiar të të gjitha organizatave buxhetore një ose më shumë qarkore buxhetore më të cilat sigurohen informata dhe udhëzime mbi (i) tavanet e shpenzimeve, të përcaktuar në KAMSH, për organizatën përkatëse buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal dhe vlerësimet jo të detyrueshme për dy vitet e ardhshme fiskale, (ii) për komunën, nivelin e granteve të përcaktuar në KAMSH dhe të llogaritur në bazë të LFPL, dhe (iii) metodologjinë dhe formularët të cilët duhet shfrytëzuar nga organizata buxhetore

gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit dhe kërkesës së saj për ndarje buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal;. Qarkoret buxhetore duhet të përfshijnë:

- a) procedurat që duhet të përdoret nga organizata buxhetore gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit dhe kërkesës së saj për ndarje buxhetore;
- b) informatat që duhet të parashtrihen në propozim-buxhet dhe në kërkesën për ndarje buxhetore;
- c) detaje mbi formatin në të cilin duhet të përgatitet propozim-buxheti dhe kërkesa për ndarje buxhetore;
- d) datën deri në të cilën organizata buxhetore duhet të përfundojë dhe dorëzojë në Ministri propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore sipas paragrafit 3 të këtij neni, dhe;
- e) udhëzime ose informata të tjera të cilat Ministri i konsideron të nevojshme.

20.3 Ministri duhet të nxjerrë qarkoren(t) buxhetore të paraparë me paragrafin 2 të këtij neni, deri me 30 Prill të vitit aktual fiskal. Data në të cilën komunat duhet t'i përfundojnë dhe dorëzojnë propozim-buxhetet dhe kërkesat e tyre për ndarje buxhetore është 30 Shtatori i atij viti. Për organizatat buxhetore të cilat nuk janë komuna, afati i fundit kohor për dorëzimin e këtyre dokumente është afati i përcaktuar në qarkoren buxhetore.

20.4 Secila organizatë buxhetore është përgjegjëse që të përgatisë dhe t'i dorëzojë Ministrit, propozim-buxhetin dhe kërkesën e saj për ndarje buxhetore në pajtim me (i) tavanin e zbatueshëm të shpenzimeve, nëse ka të këtillë; (ii) informatat dhe udhëzimet në qarkoren(et) buxhetore; dhe (iii) në rastin e komunës, shumat e aplikueshme të granteve të llogaritura me formulën e përcaktuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal.

20.5 As Ministri dhe as Qeveria nuk duhet të bëjnë ndryshimin e një propozim-buxheti ose kërkesë për ndarje buxhetore të dorëzuar nga një komunë nëse dokumenti i përmbush kushtet e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni, dhe është miratuar nga kuvendi komunal. Nëse një propozim-buxhet ose kërkesë për ndarje buxhetore e dorëzuar nga një komunë nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni, Ministri ia kthen këto dokumente kryetarit dhe kuvendit të komunës përkatëse së bashku me një shpjegim të mangësive të cilat duhet të përmirësohen. Nëse, deri në datën e përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni komuna nuk e ka dorëzuar propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore të cilat janë në përputhje me këto kushte, atëherë zbatohen dispozitat e nenit 62 të këtij ligji.

20.6 Nëse deri në datën e përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni një agjenci e pavarur nuk e dorëzon me kohë propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore, atëherë zbatohen dispozitat e paragrafit 4 të nenit 65 të këtij ligji..

20.7 Për propozim-buxhetet dhe kërkesat për përvetësime të dorëzuara nga organizatat buxhetore të cilat nuk janë agjenci të pavarura dhe komuna, pas skadimit të afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, Departamenti i Buxhetit duhet (i) të marrë të gjitha masat, të cilat mund të jenë të nevojshme për t'i sjellë këto dokumente në përputhje me kushtet e paragrafit 4 të këtij neni dhe (ii) t'ia dorëzojë këto dokumente Ministrit, së bashku me rekomandimet e Departamentit të Buxhetit.

20.8 Para datës së përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 22 të këtij ligji, Ministri duhet të përgatisë dhe t'i dorëzojë Qeverisë (i) propozim-Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësime jo të detyrueshme për secilin nga dy (2) vitet e ardhshme fiskale, (ii) Propozim Ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal, dhe (iii) KAMSH-in e azhurnuar.

20.9 Propozim Ligji për Ndarje Buxhetore i parashtron ndarjet buxhetore për të gjitha organizatat buxhetore dhe përfshin:

- a) në rast të ndarjeve buxhetore për një organizatë buxhetore, klasifikimin e secilin shpenzim të këtillë në pajtim me metodologjinë e aplikueshme të klasifikimit; duke përfshirë shpenzimet e përgjithshme faktike gjatë vitit të kaluar fiskal, si dhe vlerësimin e shpenzimeve të përgjithshme faktike për vitin aktual fiskal;
- b) në rast se ndarje buxhetore bëhet për pagimin e një borxhi të lejuar në bazë të këtij ligji, shumën (nëse ka të tillë) të ndarë:

- (i) për pagimin e interesit, ose ngarkesave të ngjashme me interesin në borxh;
- (ii) për pagimin e shumëve kryesore të borxhit;
- (iii) për pagimin e dënimeve ose shumëve të tjera që ngarkohen për pagesë të vonshme, nëse ka të tilla; dhe
- (iv) për pagimin e çfarëdo shume tjetër në lidhje me borxhin, nëse ka të tillë;

c) në rast të shpenzimeve të pa parashikuara, një ndarje të propozuar buxhetore që nuk tejkalon pesë për qind (5%) të shpenzimeve të përgjithshme.

Neni 21

Përgatitja dhe Dorëzimi i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës

21.1 Të dhënat financiare si faturat, shpenzimet dhe financimi si dhe dokumentacioni tjetër i paraqitet në propozim-Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës duhet të jetë gjithëpërfshirës, transparent dhe në përputhje me Sistemin e Klasifikimit në Bazën e Parave të Gatshme (cash basis) të SFQ i cili publikohet kohë pas kohe nga FMN. Para datës së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, Ministri duhet të përgatisë dhe t'i dorëzojë Qeverisë një propozim-Buxhet të Konsoliduar të Kosovës i cila paraqet të dhënat në vijim:

- a) një mbishikim të rrethanave ekonomike në të cilat është përgatitur buxheti dhe rekomandimet për një strategji afat-shkurte dhe afat-mesme fiskale;
- b) një shpjegim të supozimeve kyçe ekonomike që janë përdorur gjatë përgatitjes së buxhetit;
- c) një deklaratë mbi synimet dhe prioritetet e Qeverisë gjatë përgatitjes së buxhetit;
- d) vlerësime dhe parashikime për vitin e ardhshëm fiskal dhe së paku dy vitet pasuese, në lidhje me:
 - (i) të ardhurat e përgjithshme të organizatave, duke përfshirë të ardhurat e dedikuara dhe të ardhurat e parashikuara nga tarifat e shfrytëzimit, dhe burimin e të gjitha këtyre të ardhurave;
 - (ii) shpenzimet e përgjithshme, sipas kategorisë ekonomike, funksionale dhe/ose programore;
 - (iii) deficitin e përgjithshëm buxhetor ose cakun e suficitit;
 - (iv) vlerësimet e shpenzimeve të pritura në vitet e ardhshme fiskale për pagimin e blerjeve kapitale të cilat janë bërë gjatë viteve të kaluara fiskale ose që propozohet të bëhen gjatë vitit të ardhshëm fiskal;
 - (v) arkëtimet e ardhshme të cilat priten nga grantet e zotuar nga qeveritë e huaja ose organizatat ndërkombëtare në formë të përkrahjes së përgjithshme buxhetore; dhe
 - (vi) një shpjegim të ndryshimeve materiale ndërmjet vlerësimeve dhe parashikimeve të sipër cekura me vlerësimet dhe parashikimeve e parashtruara në KAMSH-in e fundit të publikuar;
- e) numrin e miratuar të punonjësve të përkohshëm dhe të përhershëm të organizatave buxhetore të cilët do të paguhet nga ndarjet buxhetore gjatë vitit të ardhshëm fiskal;
- f) nëse gjatë një viti fiskal parashihet një deficit buxhetor, një përshkrim të hollësishëm të:
 - (i) metodës së propozuar për financimin e deficitit;
 - (ii) huamarrjet e pritura, duke përfshirë hollësi mbi burimet e mundshme të huamarrjes si dhe kushtet e mundshme lidhur me shfrytëzimin dhe kthimin e huas; dhe
 - (iii) një përshkrim të pasojave që do të ketë financimi i deficitit në shpenzimet publike gjatë viteve pasuese fiskale;
- g) parashikime të hollësishme të të gjitha arkëtimeve që priten nga njësitë e përcaktuara gjatë vitit të ardhshëm fiskal; dhe
- h) deklaratata e misionit dhe plani i ekzekutimit që përfshin:

- (i) një përkufizim të misionit të secilës organizatë buxhetore;
 - (ii) një listë të qëllimeve që mund të maten, që shfrytëzohen për të vlerësuar suksesin e një organizate buxhetore rreth përmbushjes së misionit të saj;
- i) një program kapital i cili përfshin një plan shumë vjeçar për investime kapitale në Kosovë i cili identifikon dhe përfshinte nevojat më prioritare dhe propozim – projekte kapitale për vitin e ardhshëm fiskal dhe vlerësime të ndikimit financiar të projekteve të tilla në vitet e ardhshme;
 - j) vlerësime të çfarëdo shume monetare që pritet të sigurohet nga organizatat ndërkombëtare ose qeveritë e huaja në të mirë të Kosovës që nuk do të përfshihen në Fondin e Konsoliduar të Kosovës; dhe
 - k) informata mbi suficitet buxhetore, investimet detyrimet që përfshijnë:
 - (i) detajet e strategjisë së investimeve të Kosovës për paratë publike që do të investohen gjatë vitit të ardhshëm fiskal;
 - (ii) hollësitë e çdo huamarrje ose garancioni ekzistues nga organizatat buxhetore dhe çdo huamarrje ose garancion që organizatat buxhetore propozojnë për vitin e ardhshëm fiskal;
 - (iii) hollësitë e shumës së vlerësuar të detyrimeve të paparashikuara të organizatave buxhetore, duke identifikuar ato që kanë potencial të konsiderueshëm që t'i japin shkas ngritjes së detyrimeve ekzistuese gjatë vitit të ardhshëm fiskal;
 - (iv) vlerësime të hollësishme të borxheve shumë-vjeçare; dhe
 - l) për secilin nga tri vitet e ardhshme fiskale, koston e vlerësuar neto, në kushtet e të hyrave të kufizuara, të secilës dispozitë në një ligj ose Rregullore të UNMIK-ut e cila përcakton një përrjashtim, reduktim ose koncesion tatimor; dhe
 - m) çfarëdo të dhëna ose vështrime të tjera të cilat Ministri dëshiron t'i përfshijë.

Neni 22

Dorëzimi në Kuvend i Propozim Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe Propozim Ligjit për Ndarje Buxhetore

22.1 Pas miratimit të propozim Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe Propozim Ligjit për Ndarje Buxhetore, Qeveria ia dorëzon këto dokumente Kuvendit jo më vonë se më 31 tetor të atij viti fiskal.

22.2 Ministria ka të drejtë që të paralajmërohet në mënyrë adekuate dhe të marrë pjesë në cilindo dëgjim i cili mbahet nga një komision i Kuvendit lidhur me cilindo aspekt të propozim Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës ose Ligjit të Propozuar për Ndarjet Buxhetore.

Neni 23

Prioriteti i projekteve kapitale

Pas miratimit nga Kuvendi të një projekti kapital, Ministria dhe Kuvendi duhet të t'ia kushtojnë prioritetin më të lartë sigurimit të fondeve si dhe ndarjes buxhetore të nevojshme për financimin e rregullt dhe me kohë të projektit kapital gjatë përgatitjes dhe miratimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe Ligjit të Ndarjeve Buxhetore për vitin aktual dhe vitet e ardhshme.

Neni 24

Ndarjet buxhetore në mungesë të një Ligji për Ndarjet Buxhetore

24.1 Varësisht nga paragrafin 2 i këtij neni nëse një Ligj për Ndarjet Buxhetore për një vit të caktuar fiskal nuk miratohet nga Kuvendi dhe nuk shpallet në mënyrë të rregullt nga personi i autorizuar për këtë shpallje para fillimit të vitit përkatës fiskal, ligji mbi ndarjet buxhetore i cili ka qenë në fuqi vitin e mëparshëm do të trajtohet sikurse:

- a) nëse zgjedhjet e përgjithshme për deputetët e kuvendit janë mbajtur më pak se katër (4) muaj para fillimit të vitit përkatës fiskal: (i) thuajse është zgjatur për të mbuluar dy (2) muajt e parë të vitit të tillë fiskal; dhe (ii) thuajse siguron një ndarje buxhetore për çdo organizatë buxhetore, që është i barabartë me gjashtëmbëdhjetë dhe dy të tretat e përqindjes (16.67 %) të ndarjes buxhetore të siguruar për organizatën e tillë buxhetore nga ligji i ndarjeve buxhetore, ose
- b) nëse nuk ka pasur zgjedhje të tilla brenda afatit kohor (i) thuajse është zgjatur për të mbuluar muajin e parë të vitit të tillë fiskal; dhe (ii) thuajse siguron një ndarje buxhetore për çdo organizatë buxhetore, që është i barabartë me (8.33 %) të ndarjes buxhetore të siguruar për organizatën e tillë buxhetore nga ligji i ndarjeve buxhetore.

24.2 Vetëm Kuvendi, me anë të një vendimi, mund të autorizojë zgjatjen e Ligjit për Ndarjet Buxhetore të vitit të kaluar fiskal. Ligji për Ndarjet Buxhetore i vitit të kaluar fiskal, në asnjë rast, nuk mund të zgjatet për më shumë se tre (3) muaj të vitit të ardhshëm fiskal.

24.3 Nëse zgjatja e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni ose në një vendim të Kuvendit të miratuar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni ka skaduar dhe Ligji i ri për Ndarjet Buxhetore ende nuk është miratuar, atëherë asnjë organizatë buxhetore ose autoritet tjetër publik nuk mund të autorizojë asnjë shpenzim ose pagesë derisa të miratohet Ligji i ri për Ndarjet Buxhetore. Megjithatë, Ministria dhe Thesari janë të autorizuar që të bëjnë pagesa për larjen e një borxhi publik i cili është marrë në mënyrë të ligjshme sipas Pjesës IX të këtij ligji, në kohën kur ato pagesa maturohen.

24.4 Çdo ndarje buxhetore e autorizuar nga paragrafi 1 i këtij neni do të pushojë së zbatuari në datën kur një Ligj i ri mbi Ndarjet Buxhetore hyn në fuqi; dhe të gjitha shpenzimet e bëra nën autoritetin e ndarjeve buxhetore të autorizuar nga paragrafi 1 i këtij neni, do të trajtohen si shpenzime të bëra nën autoritetin e ndarjeve buxhetore të autorizuar nga Ligji i ri mbi Ndarjet Buxhetore.

PJESA V

Ligjet e rishqyrtuara dhe të plotësuara të ndarjeve buxhetore dhe buxhetet

Neni 25

Ligjet e rishqyrtuara të ndarjeve buxhetore dhe buxheteve

25.1 Ministri i Ekonomisë dhe Financave mund të përgatisë propozim ndryshim-plotësime për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe për ligjin për ndarjet buxhetore, përveç dispozitave të tyre që ndërlidhen me agjencitë e pavarura, të cilat janë në fuqi, nëse ai/ajo ka mjaft arsye për të besuar se:

- a) të ardhurat se shpenzimet për vitin fiskal, do të jenë materialisht më të ulëta apo më të larta se ato që parashihen në buxhet ose në ligjin për ndarjet buxhetore; megjithatë, një rast i vetëm i të ardhurave të jashtëzakonshme nuk është arsyetim i mjaftueshëm në mënyrë që Ministri të thirret në këtë dispozitë; ose
- b) Kuvendi me siguri do të ndryshojë apo anulojë një ligj ekzistues, apo do të miratojë një ligj të ri, dhe veprimet e tilla pritet që të ngritin apo të reduktojnë arkëtimet apo shpenzimet për vitin aktual fiskal.

25.2 Gjatë përgatitjes së propozim-ndryshimeve dhe plotësimeve, Ministri duhet të konsultohet me organizatat buxhetore që ndikohen nga plotësim-ndryshimet në fjalë. Ministri pastaj ia dorëzon propozim-ndryshimet dhe plotësimet Qeverisë së bashku me KAMSH-in e azhurnuar. Pas kësaj, procesi i miratimit të tyre është esencialisht i njëjtë me procesin e paraparë në paragrafin 8 të nenit 20 dhe nenin 22 të këtij ligji; me kusht datat specifike të përmendura në këto nene të mos përfillen, si dhe nëse propozim-ndryshimet dhe plotësimet zbatohen vetëm për pjesën e mbetur të vitit fiskal, atëherë në propozim-ndryshime dhe plotësime duhet të theksohet ky fakt.

Neni 26

Propozimi i Ligjeve të Reja ose Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjeve

26.1 Kurdo që Qeveria merr parasysh t'i propozojë Kuvendit miratimin e një ligji të ri ose ndryshimin dhe plotësimin e një ligji ekzistues, Qeveria duhet që së pari të kërkojë nga Ministri shqyrtimin e legjislacioni të propozuar dhe dorëzimin në Qeveri të një Deklarate mbi Ndikimin Buxhetor në të cilën bëhet një vlerësim detal i ndikimit që mund të ketë legjislacioni i propozuar në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe ekonominë Kosovare. Departamenti i Buxhetit, në bashkëpunim me Departamentin e Politikave Ekonomike e shqyrtojnë këtë deklaratë dhe paraqesin para Qeverisë opinionin e tyre të pavarur lidhur me këto çështje. Nëse propozim ligji ose ndryshim plotësimet u bartin komunave përgjegjësi të reja, Ministria e Pushtetit Lokal po ashtu duhet t'i paraqesë Qeverisë opinionin e saj pas konsultimit me komunat. Nëse Qeveria e miraton legjislacionin e tillë dhe e dorëzon në Kuvend për shqyrtim, Qeveria duhet që deklaratën e sipër cekur ta dorëzojë në Kuvend.

26.2 Kur, Qeveria është duke hartuar një projektligj për ta dorëzuar në Kuvend dhe ky projektligj kërkon shpenzimin e parave publike në vitin fiskal në të cilin projektligji i tillë hyn në fuqi, Ministri përgatit dhe i dorëzon Qeverisë, për procedim në Kuvend, një raport që tregon burimin ose burimet për financimin e projektligjit.

PJESA VI

Rregullat për ndarjet buxhetore

Neni 27

Skadimi i ndarjeve buxhetore në fund të viti fiskal

Të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal do të skadojnë në mesnatën e 31 Dhjetorit; megjithatë, ndarjet buxhetore të cilat ndërlidhen me të ardhurat vetanake të pashpenzuara të një komune do të vazhdojnë për komunën përkatëse në vitin e ardhshëm fiskal.

Neni 28

Tarifat dhe detyrimet bankare

Të gjitha tarifat dhe detyrimet bankare të imponuara në lidhje me mirëmbajtjen ose përdorimin e llogarive zyrtare të Fondit të Konsoliduar të Kosovës apo menaxhimin e investimeve të organizatave buxhetore, do të paguhen nga ndarjet buxhetore të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa.

Neni 29

Shpenzimet e paparashikuara

29.1 Varësisht nga paragrafi 3 i këtij neni nëse ndodh një rast për të cilin nevojiten shpenzime urgjente ose të paparashikuara, organizata përkatëse buxhetore mund të aplikojë pranë Ministrit për fonde shtesë. Në aplikacion duhet (i) të shpjegohen rrethanat të cilat kanë shkaktuar nevojën për fonde shtesë, (ii) të shpjegohen arsyet pse këto rrethana nuk kanë mundur të parashikohen, (iii) të identifikohen propozim-shfrytëzimet e fondeve të kërkuara, (iv) të shpjegohet se si këto shfrytëzime i kontribuojnë përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të organizatës buxhetore, dhe (v) të identifikohen cilat ndarje të tjera buxhetore të organizatës buxhetore mund të reduktohen me qëllim të përmbushjes së kërkesës për fonde të paparashikuara, si dhe pasojat të cilat rezultojnë nga ky reduktim i ndarjeve të tjera buxhetore.

29.2 Pas pranimit të aplikacionit, Departamenti i Buxhetit e shqyrton atë dhe ia paraqet rekomandimet Ministrit.

29.3 Ministri mund të autorizojë shpenzime nga ndarjet buxhetore të paparashikuara vetëm pas marrjes së miratimit paraprak me shkrim nga Qeveria.

Neni 30

Rregullimi i ndarjeve buxhetore të organizatës buxhetore

30.1 Një organizatë buxhetore mundet, pa marrjen e miratimit paraprak nga Ministri, të transferojë deri në pesë për qind (5%) të një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër të asaj organizate buxhetore gjatë vitit fiskal; megjithatë, këto transfere nuk mund të bëhen në ndarjen buxhetore për paga dhe mëditje pa miratimin paraprak të Ministrisë dhe, sipas rastit, Qeverisë ose Kuvendit, sipas paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni.

30.2 Ministri, nëse merr një arsyetim të vlefshëm nga udhëheqësi i një organizate buxhetore, mund të autorizoj transferimin e një pjese të një ndarje të organizatës buxhetore në një ndarje tjetër të organizatës së njëjtë; me kusht që, vlera e shumës së transferuar të mos jetë më e madhe se pesëmbëdhjetë përqind (15%) e ndarjes së ndikuar negativisht.

30.3 Nëse udhëheqësi i organizatës buxhetore, kërkon nga Ministri që të autorizojë transferimin e një shume që është më e madhe se pesëmbëdhjetë përqind 15 %, por më e vogël se njëzet e pesë përqind 25 % e ndarjes së ndikuar negativisht, atëherë Ministri mund të autorizoj një transfer të këtillë vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga Qeveria.

30.4 Nëse udhëheqësi i organizatës buxhetore kërkon nga Ministri që të autorizojë transferimin e një shume të barabartë me njëzet e pesë 25% apo më shumë, të ndarjes së ndikuar negativisht, Ministri mund të autorizojë transferimin e këtillë vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga Kuvendi.

30.5 Pavarësisht nga dispozitat e tjera të këtij neni, kryetari i komunës, pas marrjes së miratimit nga kuvendi komunal, mund të bëjë bartjen e një shume në një ndarje buxhetore të komunës në një ndarje tjetër buxhetore të komunës; me kusht që:

- a) asnjë shumë e këtillë të mos bartet nga komuna nga një ndarje specifike operative pa miratimin e Ministrisë dhe – sipas rastit – Qeverisë ose Kuvendit, sipas paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni;
- b) asnjë shumë e këtillë të mos bartet në një ndarje buxhetore për paga dhe mëditje pa miratimin e Ministrisë dhe – sipas rastit – Qeverisë dhe Kuvendit, sipas paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni; dhe
- c) kryetari i komunës menjëherë duhet t'i dërgojë një njoftim me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm të Departamentit të Buxhetit lidhur me çfarëdo bartje të bërë sipas këtij paragrafi.

Neni 31

Rregullimi i ndarjeve buxhetore në rast të ndryshimit të përgjegjësive

31.1 Kur ndarja buxhetore ndërlihet me një përgjegjësi të caktuar të një organizate buxhetore, dhe kur kjo përgjegjësi bartet ose delegohet në mënyrë të ligjshme në ndonjë organizatë tjetër buxhetore, Ministri duhet të transferojë, siç kërkohet nga rrethanat, të gjitha apo një pjesë të ndarjeve të tilla buxhetore nga organizata e parë buxhetore në organizatën tjetër.

31.2 Sidoqoftë, Ministri nuk duhet të bëjë transferimin e cilësdo pjesë të një ndarje buxhetore nëse bartja ose delegimi i përgjegjësive përkatëse nuk autorizohet shprehimisht me ligj ose Rregullore të UNMIK-ut.

Neni 32

Transferet me mallra dhe shërbime ndërmjet organizatave buxhetore

32.1 Kur një organizatë buxhetore merr mallra ose shërbime nga një organizatë tjetër buxhetore atëherë, organizata buxhetore e cila i siguron këto mallra ose shërbime duhet të kërkoj nga organizata buxhetore e cila i merr mallrat dhe shërbimet që të paguaj për mallrat në bazë të kthimit të kostos.

32.2 Nëse pagesa bëhet sipas paragrafit 1 të këtij neni, atëherë arkëtimet automatikisht shndërrohen në të ardhura të dedikuara të organizatës buxhetore e cila i ka siguruar mallrat ose shërbimet.

Neni 33

Prokurimi dhe pagimi në emër të një organizate buxhetore

33.1 Kur një organizatë buxhetore aranzhon prokurimin e mallrave apo shërbimeve që do të sigurohen, ose që janë siguruar, në të mirë të ndonjë organizate tjetër buxhetore, organizata buxhetore e cila aranzhon këtë prokurim do t'i paraqesë Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit (i) një njoftim për shpenzimin e deleguar duke treguar organizatën buxhetore në emër të të cilit është bërë prokurimi dhe (ii) pëlqimin me shkrim të ZKA të organizatës buxhetore për të cilën është bërë prokurimi.

33.2 Kur pagesa bëhet në bazë të njoftimit për shpenzimin e deleguar, siç përshkruhet në paragrafin 1 të këtij neni, shumata e paguar do të konsiderohet si pagesë prej fondeve të ndara të organizatës buxhetore për të cilën është bërë prokurimi.

PJESA VII

Zotimet, fondet e alokuara, fondet e zotuara, fondet e obliguara dhe shpenzimet

Neni 34

Kontratat që vendosin përgjegjësi për bërjen e pagesave në vitin aktual fiskal apo në vitet e ardhshme fiskale

34.1 Zyrtari Kryesor Financiar i një organizate buxhetore do të informoj Drejtorin e Përgjithshëm të Thesarit (i) për çdo kontratë të lidhur nga organizate buxhetore dhe për çfarëdo ndryshimi të ndonjë kontrate aktuale, nëse kontrata e tillë e obligon organizatë buxhetore që të bëjë pagesa gjatë vitit fiskal aktual apo gjatë viteve të ardhshme fiskale, dhe (ii) për të gjitha obligimet jashtë-kontraktuese për pagesë të organizatës buxhetore sipas paragrafit 3 të këtij neni.

34.2 Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit do të mbajë shënime mbi obligim pagesat kontraktuese dhe jashtë-kontraktuese të çdo organizate buxhetore.

34.3 Obligimi jashtë-kontraktues për pagesë, është obligimi për pagesë që kërkohet të përmbushet nga organizate buxhetore gjatë viteve të ardhshme, nëse programet ekzistuese dhe nën-njësitë (administrative dhe funksionale) të organizatës buxhetore do të vazhdojnë të financohen për ato vite të ardhshme në të njëjtin nivel dhe të njëjtën shtrirje, sikur për vitin aktual fiskal.

Neni 35

Fondet e alokuara

35.1 Brenda tridhjetë (30) ditëve pas miratimit të një Ligji për Ndarjet Buxhetore nga Kuvendi, të gjitha organizatat buxhetore duhet të përgatisin dhe t'i dorëzojnë Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit një propozim-plan për alokime i cili përcakton nevojat e arsyeshme të organizatave përkatëse buxhetore për alokime gjatë vitit përkatës fiskal. Çdo plan i këtillë duhet të jenë në përputhje të plotë me ndarjet e përcaktuara në Ligjin për Ndarjet Buxhetore.

35.2 Kur është bërë ndarja, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit do të sigurojë organizatës përkatëse buxhetore autoritetin për të bërë shpenzime nën atë ndarje:

- a) alokimit, në bazë tremujore, të fondeve nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës, të cilat do të shpenzohen nën atë ndarje buxhetore; këto fonde bëhen "fonde të alokuara" nga ajo ndarje buxhetore; dhe
- b) ndërsa shuma e fondeve të alokuara për një ndarje buxhetore ndryshon, t'i sigurojë organizatës përkatëse buxhetore, sipas nevojës, një njoftim në të cilin përcaktohet niveli fondeve që janë alokuar për shpenzim nga ndarja përkatëse.

35.3 Në raste të caktuara, kur nevojitet në bazë të rrethanave ekonomike, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit mund ta autorizojë një organizatë buxhetore që t'i bëjë disa shpenzime në baza më të përshpejtuara se sa ato që janë paraparë në pikën a) të paragrafit 2 të këtij neni.

35.4 Derisa fonde shtesë vihen në dispozicion për shpenzim në kuadër të ndarjes buxhetore, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit do të bëjë ndryshime proporcionale në nivelin e fondeve të alokuara në ndarjen buxhetore dhe do të njoftojë organizatën buxhetore për ndryshimet e tilla.

35.4 Përveç nëse ndryshohet më herët nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, njoftimi për alokimin e fondeve mbetet në fuqi deri fund të vitit fiskal.

Neni 36 **Reduktimi i fondeve të alokuara**

36.1 Përveç sikur që është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, Ministri mundet ta urdhërojë Drejtorin e Përgjithshëm të Thesarit që të bëjë reduktimin e nivelit të fondeve të alokuara nga një ndarje buxhetore e cila është autorizuar sipas një Ligji për Ndarjet Buxhetore nëse:

- a) Ministri konstaton se ky reduktim është bërë i nevojshëm për shkak të (i) një tronditje makroekonomike e cila rezulton në zvogëlimin e të ardhurave të mbledhura, (ii) një fatkeqësie natyrore ose (iii) pezullimit ose anulimit nga Qeveria të programit ose projektit për të cilin vlen alokimi, dhe
- b) Ministri pranon një autorizim me shkrim nga Qeveria me anë të të cilit miratohet reduktimi i propozuar.

36.2 Reduktimet e këtilla nuk mund të bëhen për fondet e alokuara nga të ardhurat vetanake të komunës.

Neni 37 **Fondet e zotuar**

Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit do të përcaktojë një pjesë të fondeve, apo të gjitha fondet e alokuara në një organizatë buxhetore si fonde të zotuar kur fondet në fjalë jenë të nevojshme për përmbushjen e një obligimi nga viti aktual fiskal, respektivisht për pagimin e ndonjë obligimi kontraktues siç përshkruhet në paragrafin 1 të nenit 34 të këtij ligji.

Neni 38 **Pagimi, Prioritetet**

38.1 Nuk do të lejohen kurrfarë mjetesh nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për bërjen e pagesave kur nuk ekziston një njoftim aktual për alokimin e fondeve me anë të të cilit autorizohet përdorimi i të hollave për bërjen e pagesave të tilla.

38.2 Procesi i cili do të ndiqet për bërjen e pagesave të autorizuar nga njoftimi për alokimin e fondeve, do të vendoset nga Rregullat KMF.

38.3 Në rast të mungesave mujore të parave të gatshme për shkak të një rënie të paparashikuar të të ardhurave, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit me miratimin e Ministrit duhet t'i bëjnë pagesat në bazë të prioriteteve në vijim:

- a) pagimi i borxheve të marra në mënyrë të ligjshme në përputhje me Pjesën IX të këtij ligji;
- b) shumat të cilat duhet të paguhen menjëherë për përmbushjen e një urdhri të prerë dhe pa të drejtë ankese ose një gjykim të nxjerrë nga një gjykatë sipas nenin 40 të këtij ligji;
- c) pagat dhe mëditjet për të gjitha organizatat buxhetore dhe ndihmën sociale që duhet paguar sipas ligjit;
- d) detyrimet e pakontestueshme dhe të cilat duhet të paguhen menjëherë për mallra dhe shërbime për të gjitha organizatat buxhetore;
- e) transferet dhe grantet për komunat; dhe
- f) shpenzimet kapitale.

Neni 39

Pagimi i Faturave dhe kërkesave për pagim nga njësitë e përcaktuara

39.1 ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

39.2 Kur një person ka lëshuar një faturë ose kërkesë për pagim për një organizatë buxhetore dhe shumat në fjalë nuk është paguar për një periudhë më të gjatë kohore se gjashtëdhjetë (60) ditë, personi në fjalë mundet ta dorëzojë një kopje të faturës ose kërkesës për pagim në Thesar. Pas pranimit të kopjes së faturës ose kërkesës për pagim, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, brenda tridhjetë (30) ditëve të ardhshme, do të bëjë një hetim në organizatën buxhetore për të vërtetuar nëse (i) fatura ose kërkesa për pagim është e vlefshme dhe se mallrat dhe shërbimet janë furnizuar ose punët janë realizuar, dhe (ii) shumat përkatëse nuk është paguar nga organizata buxhetore për një periudhë më të gjatë kohore se gjashtëdhjetë (60) ditë. Nëse rezultati i hetimit del të jetë pozitiv, Thesari do e paguan shumën në fjalë pa pasur nevojë të marrë miratimin paraprak të organizatës përkatëse buxhetore. Në raste të këtilla, Thesari është i autorizuar që ekzekutojë një njoftim për bartjen e shpenzimit pa miratimin paraprak të organizatës përkatëse buxhetore.

Neni 40

Pagimi i vendimeve të prera gjyqësore

40.1 Kur një gjykatë nxjerr urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë. Përmbartimi dhe pagimi sipas urdhrit ose vendimit të sipër cekur duhet të bëhet shprehimisht sipas paragrafit 3 të këtij neni dhe, sipas rastit të paragrafit 4 të këtij neni.

40.2 Pa paragjykuar fushëveprimin e përgjithshëm të nenit të mësipërm, shprehimisht përcaktohet se (i) të gjitha pagesat për përmbartimin e vendimeve ose urdhrave gjyqësore duhet të bëhen përmes LLVTH dhe (ii) as AQBK, ndonjë bankë dhe as ndonjë autoritet publik ose person (përveç Ministrisë, kur ajo vepron për përmbushjen e kërkesave të këtij neni nuk janë të autorizuar dhe nuk kanë të drejtën apo detyrimin për marrjen e çfarëdo masave për përmbartimin e vendimeve apo urdhrave të sipër cekur. Ky ndalesë vlen, mirëpo nuk kufizohet vetëm në, masat të cilat përfshijnë ngrirjen ose vënien e pengut në një llogari ose bërjen apo urdhërimin e pagesës së cilësdo shumë për përmbartimin e vendimit ose urdhrit.

40.3 Pas pranimit të vendimit të plotfuqishëm ose urdhrit të formës së prerë, Ministria është e autorizuar dhe ka përgjegjësinë që menjëherë të marrë çfarëdo masa të nevojshme për pagimin e vendimit ose urdhrit nga ndarjet buxhetore në dispozicion; me kusht që nëse vendimi i plotfuqishëm është nxjerrë

kundër një komune, vetëm përvetësimet e komunës mund të shfrytëzohen për përmbarimin e këtij vendimi.

40.4 Nëse Ministri konstaton se në vitin aktual fiskal nuk ka ndarje buxhetore të mjaftueshme për përmbarimin e urdhrimit ose vendimit, Ministri mund ta shtyjë pagimin e plotë ose të pjesëshëm të atij urdhri ose vendimit:

- a) në vitin e ardhshëm fiskal, nëse shuma e shtyrë është e barabartë ose më vogël se dy (2) milion Euro;
- b) në dy vitet e ardhshme fiskale nëse shuma e shtyrë është më shumë se dy (2) milion Euro mirëpo më pak ose e barabartë me pesë (5) milion Euro; në raste të tilla, një e dyta e shumës së shtyrë duhet të paguhet në secilin vit fiskal, së bashku me interesin i cili mund të jetë mbledhur në kohën e pagesës;
- c) në tri vitet e ardhshme fiskale, nëse shuma e shtyrë është më shumë se pesë (5) milion Euro mirëpo e barabartë ose më e vogël se nëntë (9) milion Euro; në raste të tilla, një e treta e shumës së shtyrë duhet të paguhet në secilin vit fiskal, së bashku me interesin i cili mund të jetë mbledhur në kohën e pagesës; ose
- d) në katër vitet e ardhshme fiskale, nëse shuma e shtyrë është më shumë se nëntë (9) milion Euro; në raste të tilla, një e katërta e shumës së shtyrë duhet të paguhet në secilin vit fiskal, së bashku me interesin i cili mund të jetë mbledhur në kohën e pagesës;

40.5 Shumat e shtyra në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni i nënshtrohen një shkalle të interesit e cila është e barabartë me shkallën LIBOR e cila ishte e vlefshme në ditën kur vendimi ose urdhri kishte marrë formën e prerë, plus një për qind (1%).

40.6 Shumat e shtyra si dhe çfarëdo interesi i mbledhur paguhet në përputhje me paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni, nga ndarjet buxhetore të autoritetit përkatës publik (ose, sipas rastit, organizatën buxhetore pjesë e së cilës është autoriteti publik) në Ligjin përkatës Vjetor për Ndarje Buxhetore. Ministri duhet të sigurojë që në propozim-buxhetet dhe ndarjet buxhetore të autoritetit përkatës publik (ose, sipas rastit, organizatës buxhetore pjesë e së cilës është autoriteti publik) t'u kushtohet prioritet pagimit të shumave të shtyra si dhe interesit të mbledhur në përputhje me pikën b), paragrafi 3 i neni 38 të këtij ligji.

40.7 Pas miratimit të Ligjit për Ndarjet Buxhetore në të cilin parashihet pagimi i shumës për përmbarimin e një vendimi të plotfuqishëm ose urdhri të prerë të gjykatës, Thesari nuk ka nevojë që të marrë miratimin paraprak të organizatës përkatëse buxhetore për bërjen e pagesës/ave; Thesari është i autorizuar që të ekzekutojë njoftimin për bartjen e shpenzimit sipas nevojës për bërjen e pagesës/ave.

Neni 41 Kompensimi i shpenzimeve

41.1 Nëse gjatë vitit fiskal organizata buxhetore pranon një kompensim (kthim parash) për një shumë që është paguar nën autoritetin e ndarjes buxhetore për vitin e njëjtë fiskal, shpenzimi fillestar do të reduktohet nga shuma e kompensuar.

41.2 Nëse, gjatë vitit fiskal organizata buxhetore pranon një kompensimin për një shumë e cila më parë është paguar nën autoritetin e ndarjes buxhetore për vitin e kaluar fiskal, kompensimi do të trajtohet thjeshtë si të ardhura.

PJESA VIII Raportimi, kontabiliteti dhe auditimi

KREU I

Dokumentet dhe raportimi

Neni 42

Publikimi i ligjit mbi ndarjet buxhetore dhe publikimi i buxhetit

Brenda tridhjetë (30) ditëve pas miratimit nga Kuvendi dhe shpalljes nga PSSP-ja të Buxhetit vjetor të Konsoliduar të Kosovës dhe ligjit vjetor mbi ndarjet buxhetore, Ministri do përgatisë dhe publikojë në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në faqen në internet të Ministrisë buxhetin si dhe dokumentet e tjera shpjeguese në formë gjithëpërfshirëse dhe të kuptueshme nga publiku, në gjuhët zyrtare që përdoren për dokumentet e Qeverisë.

Neni 43

Buxhetimi dhe regjistrat kontabël në Thesar

43.1 Ministri do të themelojë një sistem për klasifikim buxhetor si dhe një diagram të llogarive me qëllim të:

- a) mundësimin të përgatitjes strategjike dhe efektive si dhe ekzekutimit të KAMSH dhe buxheteve vjetore,
- b) lehtësimin të kontrollimit të shpenzimeve nga organizatat buxhetore;
- c) mundësimin të kryerjes së analizave të zotimeve dhe shpenzimeve nga organizatat buxhetore, sipas kategorisë funksionale kategorisë ekonomike, në një mënyrë që i përmbush nevojat e Kosovës për raportim të brendshëm dhe të jashtëm dhe që bazohet në standardet e aplikueshme të miratuara nga FNK; dhe
- d) mundësimin të kryerjes së analizave të tjera të cilat Ministri i konsideron të nevojshme.

43.2 Diagrami i llogarive duhet të jetë në përputhje me SFQ. Sistemi i klasifikimit mund të ndryshohet për t'i përmbushur nevojat e caktuara të Qeverisë për informacion. Nëse ka çfarëdo ndryshimi ndërmjet sistemit të klasifikimit dhe diagramit të llogarive, Departamenti i Buxhetit duhet të përgatisë një tabelë urë lidhëse.

43.3 Ministri do të mbajë në minimum, regjistrat kontabël për secilën organizatë buxhetore që tregon informatat e përgjithshme për secilën prej kategorive më poshtë:

- a) arkëtimet e organizatës buxhetore;
- b) detyrimet e papaguara të organizatës buxhetore;
- c) pasuritë e organizatës buxhetore;
- d) ndarjet buxhetore,
- e) rregullimet e ndarjeve buxhetore;
- f) ndarjet buxhetore që janë vënë në dispozicion për organizatën buxhetore për shpenzim me anë të njoftimeve për fondet e alokuara;
- g) shtrirjet në të cilat fondet e alokuara të organizatës buxhetore janë shënuar si fonde të zotuara; dhe
- h) shpenzimet faktike të bëra.

Neni 44

Regjistrat kontabël të organizatës buxhetore

44.1 Zyrtari Kryesor Financiar i organizatës buxhetore, do të regjistrojë të gjitha transaksionet dhe do të mbaj regjistrat kontabël në përputhje me Rregullat KMF, si dhe të sigurojë kopjet e regjistrave kontabël për Ministrin e Financave dhe Ekonomisë.

44.2 Zyrtari Kryesor Financiar i një organizate buxhetore dhe Zyrtari Kryesor Administrativ, tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të çdo viti fiskal, do të sigurojë Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit (i) deklaratat e pa-audituar financiare të organizatës buxhetore për vitin përkatës fiskal dhe (ii) një konfirmim me shkrim se këto deklarata financiare të organizatës buxhetore për vitin fiskal në fjalë, janë një pasqyrim i vërtetë dhe i drejtë i financave dhe transaksioneve financiare të organizatës buxhetore për vitin përkatës fiskal.

44.3 Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas mbylljes së çdo viti fiskal do të (i) bashkërendojë deklaratat financiare sipas paragrafit 2 të këtij neni me llogaritë fiskale dhe balancet e parave të gatshme, dhe (ii) do t'i sigurojë Auditorit të Përgjithshëm deklaratat financiare të të gjitha organizatave buxhetore për auditim.

44.4 Çdo organizatë buxhetore poashtu duhet t'i dorëzojë Ministrit një raport vjetor për vitin e kaluar fiskal. Ky raport duhet të dorëzohet brenda një muaji pas pranimit nga organizata buxhetore të deklaratave të saj financiare të audituara për vitin përkats fiskal. Ky raport duhet të përfshijë:

- a) një raportim mbi veprimtarinë e organizatës buxhetore, duke përfshirë një Deklaratë të Rezultateve në të cilën identifikohen arritjet (rezultatet) kundrejt planit të veprimit i cili është dorëzuar në Kuvend sipas pikës h), paragrafi 1 i nenit 21 të këtij ligji; dhe
- b) deklaratat e audituara financiare për vitin fiskal që paraqesin:
 - (i) ndarjet buxhetore të bëra për organizatën buxhetore për vitin fiskal;
 - (ii) detajet reale të shpenzimeve kapitale dhe operative të organizatës buxhetore për vitin fiskal; dhe
 - (iii) numrin e shërbyesve civil të përhershëm dhe të përkohshëm në fillim dhe në fund të viti fiskal; dhe

44.5 Organizata buxhetore do ti mbajë regjistrat kontabël dhe financiar për së paku 7 vite pas vitit fiskal për të cilin ato vlejné.

44.6 Ministri do t'i dorëzojë Kuvendit dhe Qeverisë një raport të konsoliduar mbi secilën organizatë buxhetore brenda tridhjetë (30) ditëve pasi që ky raport t'i jetë dorëzuar Ministrit nga organizata përkatëse buxhetore..

Neni 45 Raportet tremujore buxhetore

45.1 Ministri do të përgatitë dhe Qeveria do të shqyrtojë raportet tremujore që mbulojnë vitin fiskal për çdo çerek viti të përfunduar. Raportet e tilla do t'i parashtrihen Kuvendit brenda tridhjetë (30) ditëve nga mbarimi i çdo çerek viti dhe të publikohen nga Ministri.

45.2 Raportet tremujore të dorëzuara sipas paragrafit 1 të këtij neni përfshijnë (i) raportin mbi arkëtimet dhe shpenzimet që përmban të dhënat e përcaktuara me pikën b) paragrafi 2 i nenit 46 të këtij ligji, (ii) të dhënat mbi investimet dhe detyrimet që përmbajnë të dhënat e përcaktuara me pikën c) paragrafi 2 i nenit 46 të këtij ligji, dhe (iii) një deklaratë nga Ministri mbi atë se a janë të mjaftueshme apo jo arkëtimet aktuale për të financuar ndarjet buxhetore të përcaktuara në ligjin mbi ndarjet buxhetore.

45.3 Nëse, në raportin tremujor, Ministri tregon se nuk ka fonde të mjaftueshme aktuale ose të ardhshme për financimin e ndarjeve buxhetore të përcaktuara me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, Ministri duhet që menjëherë të konsultohet me Drejtorin e Përgjithshëm të Thesarit dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Departamentit të Buxhetit mbi këtë çështje dhe të përgatisë një propozim për reduktimin e fondeve të alokuara. Para se propozimi në fjalë të zbatohet, Ministri duhet të kërkojë dhe të marrë miratimin e Qeverisë sipas nenit 36.

45.4 Kryetari i komunës duhet të përgatitë dhe t'i dorëzojë kuvendit komunal raporte tremujore të cilat mbulojnë vitin fiskal deri në fund të tremujorit i cili sapo ka përfunduar. Këto raporte duhet t'i dorëzohen kuvendit komunal dhe një kopje duhet t'i dorëzohet ministrit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të çdo tremujori dhe më pas duhet të publikohen nga kryetari i komunës në faqen e internetit të komunës. Çdo raport i këtillë duhet të paraqesë informatat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni së bashku me një përmbledhje të statusit të të gjitha projekteve kapitale të shpenzimit.

Neni 46

Raporti përfundimtar mbi buxhetin

46.1 Jo më vonë se me 31 Mars të çdo viti kalendarik, Ministri do të përgatitë dhe dorëzojë Qeverisë, për miratim dhe dorëzim në Kuvend, një raport përfundimtar përmbledhës të buxhetit për vitin e kaluar fiskal dhe dy vitet paraprake fiskale, i cili përfshin:

- a) një raport mbi të ardhurat dhe shpenzimet, i cili paraqet të dhëna krahasimore për këto vite lidhur me:
 - (i) një mbishikim të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike;
 - (ii) një mbishikim të ndonjë deficiti ose suficiti buxhetor si dhe mënyra se si është financuar deficit ose si është investuar suficiti;
 - (iii) të ardhurat faktike, të identifikuar sipas llojit, të organizatave buxhetore të krahasuara me parashikimet përkatëse në cilat janë përfshirë në buxhet;
 - (iv) shpenzimet faktike në lidhje me secilën kategori të shpenzimit krahasuar me (1) ndarjen buxhetore për atë kategori, dhe (2) shpenzimin faktik për atë kategori gjatë vitit të kaluar kalendarik;
 - (v) të ardhurat e defikuara faktike të pranuar, të identifikuar sipas llojit, dhe shpenzimet faktike, sipas klasifikimit, nga ndarjet buxhetore për të ardhurat e dedikuara; dhe
 - (vi) numri faktik i punonjësve të përhershëm dhe të përkohshëm të organizatave buxhetore krahasuar me numrat e autorizuar në buxhet;
 - (vii) pagesat faktike të interesit ose shumave në natyrën e interesit në borxh, sikur që është paraparë në nenet 50 dhe 51 të këtij ligji si dhe për pagimin e shumës kapitale të borxhit;
 - (viii) detale mbi të gjithë pranuesit e granteve publike të bëra gjatë vitit fiskal si dhe shumat të cilat ata i kanë pranuar;
 - (ix) detale të shpenzimeve nga ndarjet buxhetore për shpenzime të jashtëzakonshme, të përshkruara në nenin 29 të këtij ligji; dhe
 - (x) detale mbi të gjitha rregullimet të cilat janë bërë në ndarje buxhetore, në përputhje me nenet 30 dhe 31 të këtij ligji.
- (b) informata mbi investimet dhe detyrimet, duke përfshirë:
 - (i) detale lidhur me investimet e parave publike të cilat janë kryer gjatë vitit fiskal;
 - (ii) detale mbi ndonjë detyrim të përshkruar në nenet 50 ose 51 të këtij ligji;
 - (iii) një llogaritje të plotë të aseteve të cilat mbahen nga organizatat buxhetore në fund të vitit fiskal; dhe
 - (iv) një vlerësim të të gjitha detyrimeve kontigjente, duke përfshirë një vlerësim të riskut të këtyre detyrimeve kontigjente.

46.2 Kryetari i komunës duhet të përgatitë dhe t'i dorëzojë kuvendit komunal një raport përfundimtar përmbledhës buxhetor i cili përmban të dhënat e përcaktuara në nenin 46.1, sikur që aplikohen ato për komunën përkatëse.

KREU II Auditimi i jashtëm

Neni 47 Auditimi nga Auditori i Përgjithshëm

47.1 Auditori i Përgjithshëm do të përgatisë dhe t'i dorëzojë Kuvendit një raport mbi deklaratat financiare të organizatave buxhetore dhe ndërmarrjeve publike për vitin e kaluar fiskal. Nëse organizata buxhetore është komunë, raporti po ashtu duhet t'i sigurohet kuvendit komunal. Ky raport do të parashtrijë opinionet e Auditorit të Përgjithshëm mbi atë se nëse deklaratat financiare të organizatave të këtyre buxhetore japin

një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë të financave të këtyre organizatave buxhetore dhe ndërmarrjeve publike.

47.2 Auditori i Përgjithshëm do të ketë qasje të pakufizuar në të gjitha informatat dhe shpjegimet që për mendimin e tij/saj janë të nevojshme me qëllimin të ekzekutimit të auditimit financiar.

47.3 Auditori i Përgjithshëm do të paraqesë një raport në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni deri më 31 Korrik në vijim të vitit fiskal me të cilin ndërlidhet raporti.

47.4 Kopjet e raportit të Auditorit të Përgjithshëm do të vihen në dispozicion të publikut.

Neni 48 **Auditimi nga jashtë i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës**

Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk e pengon ose ndikon dhe nuk mund të interpretohet për të penguar ose ndikuar në autoritetin e Auditorit të Përgjithshëm për të audituar ose për të bërë aranzhimin e auditimit të jashtëm të cilësdo organizatë buxhetore, autoritet publik ose ndërmarrje publike në çdo kohë.

PJESA IX **Kufizimet në Huamarrje, Garantime, Huadhënie, Kapitalizim, Grante dhe Subvencione**

Neni 49 **Kufizimet e Përgjithshme**

49.1 Përveç në rastet e përcaktuara në nenet 50-54 të këtij ligji, asnjë organizatë buxhetore, autoritet publik ose ndërmarrje e kontrolluar publike nuk duhet të bëjë një marrëveshje të çfarëdo lloji në të cilën përfshihet huazimi i parave, zgjatja e një huadhënie ose vendosja e një kredie.

49.2 Përveç në rastet e përcaktuara në nenet 50-54 të këtij ligji, asnjë organizatë buxhetore, autoritet publik ose ndërmarrje e kontrolluar publike, (i) nuk mund të lëshojë asnjë instrument, siç mund të jetë ndonjë obligacion (instrument detyrimi) apo letër-vlerë huamarrje kundrejt besueshmërisë (premtim i paguarantuar pagese) duke vendosur kështu një obligim borxhi në organizatën buxhetore, autoritetin publik ose ndërmarrjen e kontrolluar publike, (ii) nuk do të garantojë apo sigurojë efektshmërinë apo ri-pagimin e një borxhi apo obligimi të çfarëdo organizate buxhetore, autoriteti publik, ndërmarrje ose person, ose, (iii) të merret me çfarëdo aktiviteti huadhënës.

49.3 Përveç nëse autorizohet shprehimisht me një ligj të nxjerrë nga Kuvendi, asnjë organizatë buxhetore, autoritet publik ose ndërmarrje e kontrolluar publike nuk mund të themelojë, kapitalizojë, marrë ose shfrytëzojë para publike ose çfarëdo fonde ose asete publike për të themeluar, kapitalizuar ose marrë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi një ndërmarrje ose një interes në një ndërmarrje. Ky kufizim nuk mund të interpretohet për të kufizuar autoritetin e Qeverisë për të marrë nga AKM aksionet në njësitë e përcaktuara në Listën A.

49.4 Aktet e bëra, marrëveshjet ose instrumentet e ekzekutuara të borxhit, nga cilado organizatë buxhetore, autoritet publik ose ndërmarrje e kontrolluar publike dhe që është në kundërshtim me kufizimet e përcaktuara në këtë nen janë të pavlefshme dhe të pa zbatueshme, përveç siç thuhet në mënyrë specifike sipas neneve 50-54 të këtij ligji.

Neni 50 **Përfshirjet e Veçanta**

50.1 Kufizimet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 49 të këtij ligji nuk zbatohen për:

- a) marrëveshjet e lidhura sipas Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare Financiare;

- b) një instrument të borxhit ose sigurim të borxhit të nxjerrë nga Qeveria e Kosovës nëse Kuvendi shprehimisht e ka paraparë nxjerrjen e këtij instrumenti ose sigurimi në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës;
- c) një marrëveshje për huamarrje të lidhur nga Qeveria e Kosovës, e cila mundëson huamarrjen e parave nga Qeveria e Kosovës, nëse Kuvendi shprehimisht e ka paraparë këtë huamarrje në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

50.2 Kufizimet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 49 të këtij ligji nuk zbatohen për shumat që i ofrohen një njësie të përcaktuar nga një organizatë buxhetore në formë të ndihmës financiare në bazë të autorizimit të një Ligji Vjetor për Ndarjet Buxhetore. Përveç nëse në ligjin përkatës për ndarjet buxhetore kjo ndihmë është karakterizuar si "grant" - të gjitha këto shumat nuk do të trajtohen si grant ose donacion; por si hua për njësinë e përcaktuar. Kjo hua prodhon efektin e pengut të prioritetit më të lartë në të mirë të Qeverisë dhe që mund të përmbahet nga Qeveria ndaj pasurisë së njësisë së përcaktuar, duke përfshirë asetet e marra pas dhënies së huas.

50.3 Pavarësisht kufizimeve të paragrafit 2 të nenit 49 të këtij ligji, Ministri, pas marrjes së miratimit nga Qeveria e Kosovës, mund të ekzekutojë një garancion.

Neni 51 Përgjithshme

Qeveria mundet, me qëllim të huazimit ose garantimit për ri-pagim të parave të cilat nevojiten për përmbushjen e një qëllimi legjitim publik, të marrë hua ose të bëjë një marrëveshje garantimi me (i) një institucion ndërkombëtar financiar të saktësuar në Listën B të këtij ligji; ose (ii) me ndonjë institucion tjetër financiar, nëse lënda primare e një marrëveshje të tillë përfshin zgjatjen e një huamarrjeje apo themelimin e një mjete kreditues të garantuar ose të siguruar nga një institucion ndërkombëtar financiar i përcaktuar në Listën B. Qëllimi i marrëveshjes së propozuar dhe shumata e cila propozohet në huazohet ose të garantohet duhet të përcaktohet shprehimisht në Buxhetin e miratuar të Konsoliduar të Kosovës.

Neni 52 Ministri i Financave në cilësinë e Agjentit të Vetëm të Autorizuar

Ministri vepron në cilësinë e agjentit të Qeverisë për të gjitha aktivitetet huamarrëse të Qeverisë. Ministri është përgjegjës për kryerjen e të gjitha negociatave dhe lidhjen e të gjitha marrëveshjeve apo aranzhimeve të huamarrjes dhe në bazë të këtij ligji autorizohet si agjenci i vetëm i Qeverisë për këtë qëllim.. Ministri është shprehimisht i autorizuar që:

- a) ta përfaqësojë Qeverinë gjatë ushtrimit të aktiviteteve të saj të huamarrjes ose garantimit;
- b) të kryejë të gjitha negociatat me palët huazuese dhe palët e treta në emër të Qeverisë;
- c) të ekzekutojë të gjitha dokumentet e huazimit ose garantimit në cilësinë e agjentit të autorizuar të Qeverisë; dhe
- d) të mbajë origjinalin e marrëveshjes dhe të gjitha dokumentet tjera përcjellëse.

Neni 53 Kufizimet në Grante, Donacione dhe Subvencione

53.1 Asnjë organizatë buxhetore ose autoritet publik nuk mund të japin një grant, donacion ose subvencion për një person ose ndërmarrje, përveç dhe deri në masën e lejuar shprehimisht nga një ligj mbi ndarjet buxhetore.

53.2 Nëse në një ligj për përvetësime autorizohet një organizatë buxhetore ose autoritet publik që të japë një grant, donacion ose subvencion për një ose më shumë persona dhe/ose ndërmarrje, atëherë kjo organizatë buxhetore ose ky autoritet publik duhet t'i përmbushin të gjitha kushtet e përcaktuara në Ligjin përkatës të Ndarjeve Buxhetore si dhe rregullat e nxjerra nga Ministri sipas paragrafit 3 të këtij neni gjatë dhënies së grantit, donacionit ose subvencionit.

53.3 Ministri është shprehimisht i autorizuar që të nxjerrë rregullat të cilat duhet të respektohen nga organizatat buxhetore ose autoritetet publike gjatë përzgjedhjes së pranuesit ose pranuesve si dhe përcaktimit të shumës ose shumave të cilat do të open në formë të grantit, donacionit ose subvencionit. Këto rregulla duhet të sigurojnë që procesi të ketë për qëllim arritjen e synimeve të Kuvendit kur i njëjti e ka autorizuar grantin, donacionin ose subvencionin përkatës në ligjin përkatës për ndarjet buxhetore.

Neni 54

Kontratat e Ortakërisë Publiko-Private

54.1 Pavarësisht nga kufizimet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 49 të këtij ligji, organizata buxhetore ose autoriteti publik mund të hap tender dhe të japë një kontrate të ortakërisë publiko-private nëse;

- a) projekti dhe kushtet e tenderit përkatës, para publikimit, janë miratuar paraprakisht nga Ministri;
- b) tenderimi dhe dhënia e kësaj kontrate janë në përputhje materiale me dispozitat e aplikueshme të Ligjit mbi Procedurën për Dhënie dhe Koncesioneve dhe Ligjit për Prokurim Publik.
- c) kontrata kryesore si dhe të gjitha nën-marrëveshjet apo marrëveshjet anësore kanë kohëzgjatje që është e arsyeshme duke marrë parasysh madhësinë dhe lëndën e kontratës ose marrëveshjes;
- d) procesi i tenderimit dhe dhënies së kontratës janë në përputhje me të gjitha rregullat për ortakëritë publiko-private të nxjerra nga BE ose një autoritet ekzekutiv i BE-së; dhe
- e) kontrata përfundimtare e ortakërisë publiko-privatë është miratuar nga Qeveria dhe është nënshkruar nga Ministri dhe personi ose personat përgjegjës të autorizuar për nënshkrim në organizatën buxhetore.

54.2 Para tenderimit të një Kontrate të Ortakërisë Publiko-Private, organizata buxhetore ose autoriteti publik duhet që së pari të përgatisë dhe dorëzojë Ministrit një kërkesë formale lidhur me përkrahjen e nevojshme buxhetore, e cila përfshin (i) një përkrahje të hollësishëm të llojit, shumës së propozuar dhe kohëzgjatjes së përkrahjes së kërkuar buxhetore (ii) një përkrahje gjithëpërfshirës dhe të hollësishëm të projektit duke përfshirë edhe matricën e rrezikut të projektit, (iii) një hulumtim të hollësishëm të fizibilitetit financiar, (iv) një draft të kontratës kryesore të propozuar dhe (v) çfarëdo dokumenti tjetër që kërkohet nga Ministri.

54.3 Pas pranimit të informatave të kërkuara, Ministri ia përcjell kërkesën dhe dokumentet e tjera NJOPP, e cila menjëherë kryen një rishikim teknik të tyre. NJOPP ia paraqet Ministrit opinionin e saj profesional lidhur me arsyeshmërinë e kërkesës për përkrahje buxhetore brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas fillimit të rishikimit të sipër cekur. Në këtë opinion, NJOPP duhet të përfshijë edhe një analizë të riskut të të gjitha detyrimeve kontingjente të cilat ndërlidhen me kërkesën e sipër cekur.

54.4 Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të opinionit të NJOPP, Ministri e refuzon ose e miraton kërkesën me shkrim. Ministri mund ta miratojë përkrahjen e kërkuar buxhetore plotësisht ose pjesërisht. Ministri po ashtu mund të kushtëzojë miratimin e tij. Të gjitha miratimet e Ministrit duhet të ratifikohen nga Qeveria para se të hyjnë në fuqi.

54.5 Nëse Qeveria e ratifikon vendimin e Ministrit, (i) Ministri duhet që menjëherë të zbulojë në tërësi para publikut dhe Kuvendit të gjitha aspektet materiale të përkrahjes buxhetore e cila është dhënë ose do të jepen për një Kontratë Ortakërie Publiko-Private dhe (ii) autoriteti kontraktues mund ta vazhdojë procesin e tenderimit; megjithatë, pas përfundimit të këtij procesi, për dhënie dhe kontratës nevojitet miratimi i Qeverisë.

PJESA X
Përgjegjësia e Ndërmarrjeve Autonome Publike

Neni 55
Grantet për Ndërmarrjet Autonome Publike

Organizata buxhetore mund të sigurojë një grant për një ndërmarrje autonome publike vetëm nëse një ndarje buxhetore për organizatën përkatëse buxhetore shprehimisht dhe në mënyrë të saktë e autorizon një grant të tillë, dhe, në raste të tilla, organizata buxhetore do të sigurojë që çfarëdo kushti i vendosur nga ndarja buxhetore në një grant të tillë të respektohet plotësisht.

Neni 56
Njoftimi mbi Ngjarjet e Rëndësishme

Nëse një ndërmarrje autonome publike propozon të ndërmarrë cilindo nga veprimet në vijim, ndërmarrja autonome publike duhet që së pari ti sigurojnë Ministrin një raport me shkrim i cili përmban informata të hollësishme mbi veprimin e propozuar:

- a) themelimin ose marrjen pjesë në themelimin e një personi juridik, kompanie, ortakërie, trusti, sipërmarrje të përbashkët afariste pa personalitet juridik, ose çfarëdo shoqërie tregtare ose jo-tregtare ose shoqate;
- b) të kërkojë, ekspozojë apo të modifikoj karakterin apo përmasat e shtrirjes së çfarëdo interesi të mbajtur nga një organizatë apo shoqatë e përmendur në pikën (a);
- c) përvetësimin apo rregullimin e çfarëdo pasurie operative apo të rëndësishme;
- d) shuarjen, zgjerimin apo modifikimin e veprimtarive,
- e) ushtrimin e interesave pronësore ndaj cilësdo prej organizatave apo shoqatave të përmendura në pikën (a), më lartë, për të nxitur një organizatë të tillë që të ndërmarrë veprimet e saktësuara nën pikat (a)-(d) më lartë; dhe
- f) angazhimin në çfarëdo aktiviteti huamarrës ose huadhënës.

PJESA XI
Komunat

KREU I
Dispozitat e Përgjithshme

Neni 57
Zbatimi i këtij ligji në komuna

Të gjitha dispozitat e këtij ligji zbatohen për komunat njëjloj si për organizatat e tjera buxhetore, përveç (i) nëse shprehimisht është përcaktuar ndryshe në këtë Pjesë XI ose në një dispozitë tjetër të këtij ligji, ose (ii) nëse zbatimi i dispozitës për një komunë bie ndesh me LFPL.

Neni 58
Të ardhurat komunale

58.1 Përveç për përkrahjen financiare për një komunë e cila epet nga Republika e Serbisë, të gjitha paratë ose të ardhurat e mbledhura ose pranuar nga një komunë, pavarësisht nëse kualifikohen si “të ardhura vetanake komunale” duhet të depozitohen menjëherë në llogarinë përkatëse zyrtare bankare. Përkrahja financiare e dhënë nga Republika e Serbisë duhet që menjëherë të depozitohet në (i) një llogari zyrtare bankare ose (ii) në një llogari në një bankë komerciale në përputhje me kushtet e përcaktuara në LFPL.

58.2 Pas depozitimit në një llogari zyrtare bankare, komuna duhet ta regjistrojë depozitën në Regjistrin Kontabël të Thesarit në përputhje me Rregullat KMF, në regjistër duhet të përcaktohet (i) shuma e përgjithshme të depozituar, (ii) një klasifikim i fondeve të depozituara sipas burimit, dhe (iii) të gjitha informatat e tjera që kërkohen sipas Rregullave KMF. Të gjitha të ardhurat e depozituara në llogarinë zyrtare bankare të komunës duhet të transferohen në llogarinë përkatëse në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në mënyrën dhe brenda afatit të përcaktuar në Rregullat e KMF.

58.3 Të gjitha shumat e depozituara dhe që hyjnë në përkufizimin e “të ardhurave vetanake komunale” janë të ardhura të dedikuara të komunës përkatëse. Këto të ardhura i ndahen komunës përkatëse në pajtim me propozim-buxhetin dhe kërkesën e saj për ndarje buxhetore.

Neni 59 **Ndihma Financiare nga Republika e Serbisë**

59.1 Komunitetët kanë të drejtë që të pranojnë ndihmë financiare nga Republika e Serbisë.

59.2 Të gjitha ndihmat financiare për një komunë nga Republika e Serbisë (i) janë të ardhura të dedikuara të asaj komune dhe (ii) do të shfrytëzohen nga komuna vetëm për qëllime që ndërlidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e kompetencave të saj komunale.

59.3 Komuna duhet të sigurojë që të gjitha këto ndihma financiare të depozitohen (i) në një llogari zyrtare bankare në pajtim me kërkesat e përcaktuara në LMFPP ose (ii) në një llogari në një bankë komerciale e cila është certifikuar nga AQBK. Nëse një ndihmë financiare depozitohet në një bankë komerciale, komuna duhet ta regjistrojë atë depozit në Regjistrin Kontabël të Thesarit në përputhje me Rregullat KMF, ku duhet të përcaktohet (i) shuma e përgjithshme e depozituar, (ii) burimi i fondeve të depozituara, dhe (iii) të gjitha të dhënat e tjera që kërkohen sipas Rregullave KMF.

59.4 Nëse ndihma financiare depozitohet në një llogari zyrtare bankare, atëherë kjo ndihmë do t'i përvetësohet komunës në pajtim me propozim-buxhetin dhe kërkesën e saj për ndarje buxhetore nëse këto dokumente përcaktojnë se kjo ndihmë financiare do të shfrytëzohet nga komuna vetëm për qëllime që ndërlidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e kompetencave të saj komunale.

59.5 Nëse ndihma financiare depozitohet në një llogari në një bankë komerciale, komuna mund t'i shfrytëzojë lirshëm këto mjete për çfarëdo qëllimi i cili ndërlidhet drejtpërdrejtë me ushtrimin e kompetencave të saj komunale. Sidoqoftë, të gjitha shpenzimet nga kjo ndihmë financiare duhet të raportohen menjëherë nga komuna në Thesar sipas Rregullave KMF.

59.6 Të gjitha këto ndihma financiare janë të përjashtuara nga taksat, tarifat, detyrimet ose shumat e ngjashme të cilat parashihen me ligj ose të cilat kërkohen të shqiptohen ose mbledhen nga një autoritet publik.

59.7 Kjo ndihmë financiare nuk merret parasysh, në asnjë mënyrë, nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Komisioni i Granteve ose Kuvendi gjatë përcaktimit të shumës për një Grant ose një ndarje buxhetore për komunën përkatëse.

Përgatitja e Propozim Buxhetit dhe Kërkesës për Ndarje Buxhetore nga Komuna

Neni 60

Përgatitja dhe rishqyrtimi i propozim-buxheteve dhe kërkesave për ndarje buxhetore nga ZKF dhe Kryetari i Komunës

60.1 ZKF i komunës duhet, me ose para 1 Korrikut të vitit aktual kalendarik, t'i dërgojë kryesuesit të secilit departament komunal të komunës një qarkore buxhetore komunale e cila përmban informata dhe udhëzime mbi (i) tavanet e shpenzimeve të aplikueshme për departamentin përkatës për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësime mbi këto tavane për dy (2) vitet e ardhshme fiskale, dhe (ii) metodologjinë dhe formularët që duhet të shfrytëzohen nga departamenti përkatës gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal. Qarkorja buxhetore duhet të përfshijë:

- a) procedurat që duhet përdorur nga departamenti gjatë përgatitjes së propozim buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore;
- b) të dhënat të cilat duhet të parashtrihen në propozim-buxhet dhe në kërkesën për ndarje buxhetore;
- c) detale mbi formatin në të cilin duhet të përgatitet propozim-buxheti dhe kërkesa për ndarje buxhetore; dhe
- d) afatin e fundit deri në të cilin departamenti duhet të përfundojë dhe t'i dorëzojë ZKF-së propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore.

60.2 Pasi skadimit të afatit kohor të përcaktuar në qarkoren e brendshme buxhetore, ZKF duhet (i) të shqyrtojë propozim-buxhetet dhe kërkesat për ndarje buxhetore të cilat janë dorëzuara nga departamentet komunale, dhe (ii) të mbajë takime me secilin departament me qëllim të shqyrtimit dhe kuptimit të propozim-buxhetit dhe të departamenteve përkatëse si dhe për të bërë përpjekje për zgjidhjen e çështjeve dhe shqetësime që kanë të bëjnë me propozim-buxhetin, veçanërisht sa ka të bëjë me përputhshmërinë e propozim-buxhetit me Tavanet e Brendshme Komunale të Shpenzimeve dhe qarkoren buxhetore komunale.

60.3 Pas mbajtjes së takimeve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni, ZKF duhet të përgatisë dhe t'i dorëzojë Kryetarit të Komunës Buxhetin e propozuar Komunal për vitin e ardhshëm fiskal dhe vlerësime për dy (2) vitet e ardhshme fiskale. Këto dokumente duhet të dorëzohen në formën e cila është në pajtim me qarkoren buxhetore të nxjerrë nga Ministri. ZKF duhet që njëkohësisht t'u shpërndajë departamenteve komunale të komunës propozim-buxhetin për vitin e ardhshëm fiskal.

Neni 61

Shqyrtimi i Buxhetit Komunal nga Kuvendi Komunal

61.1 Pas miratimit të propozim-Buxhetit Komunal nga Kryetari i Komunës, Kryetari i Komunës, deri me 1 Shtator të vitit përkatës fiskal, duhet t'ia dorëzojë këto dokumente Kuvendit Komunal. Të dhënat financiare si faturat, shpenzimet dhe financimi si dhe dokumentacioni tjetër i paraqitet në propozim-Buxhetin Komunal duhet të jetë gjithë përfshirës, transparent dhe në përputhje me Sistemin e Klasifikimit në bazën e parave të gatshme të SFQ i cili publikohet kohë pas kohe nga FMN. Propozim-Buxheti Komunal duhet të përfshijë:

- a) parashikime dhe supozime ekonomike dhe buxhetore;
- b) vlerësime të përgjithshme të të ardhurave nga të gjitha burimet, duke përfshirë (i) grantet, në përputhje me shumat e këshilluara në qarkoren(t) buxhetore të nxjerra nga Ministri, (ii) ndihmën nga burimet jashtë Kosovës, dhe (iii) të ardhurat e parashikuara vetanake të komunës;
- c) një cak të përgjithshëm të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimit;
- d) vlerësime të përkrahjes së pritur nga donatorët; dhe
- e) çfarëdo të dhëna të tjera me rëndësi materiale për buxhetin të cilat ZKF e konsideron të arsyeshme për t'u përfshirë.

61.2 Pas pranimit të propozim-buxhetit, Kuvendi Komunal do të mbajë dëgjime publike në përputhje me aktet e aplikueshme ligjore të komunës. Pas këtyre dëgjimeve, Kuvendi Komunal, deri në datën e përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 20 të këtij ligji, duhet të shqyrtojë, ndryshojë siç e sheh të nevojshme ose të arsyeshme si dhe të miratojë dhe t'ia dorëzojë Ministrin propozim-buxhetin Komunal.

61.3 Buxheti i miratuar Komunal duhet të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji dhe udhëzimet e dhëna në qarkoret buxhetore të nxjerra nga Ministri.

Neni 62

Mos dorëzimi me kohë i propozim-buxhetit dhe kërkesës për ndarje buxhetore nga komuna

62.1 Nëse kryetari i komunës dështon që t'ia dorëzojë Kuvendit Komunal propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore deri me 1 Shtator të vitit aktual fiskal sipas paragrafit 1 të nenit 61 të këtij ligji:

- a) Ministri menjëherë bën emërimin e një administratori financiar komunal për komunën në fjalë dhe pas këtij emërimi, të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë të cilat i janë dhënë kryetarit të komunës sipas këtij ligji ose LFPL shndërrohen në të drejta dhe përgjegjësi të administratorit financiar komunal; dhe
- b) Kryetari i komunës i nënshtrohet procedurave të përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

62.2 Nëse kuvendi komunal dështon që me kohë të bëjë miratimin dhe dorëzimit të Ministrit të propozim-buxhetit komunal dhe kërkesës për ndarje buxhetore të cilat janë në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë ligj deri në datën e përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 20 të këtij ligji, Ministri është i autorizuar që të përgatitë propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore për këtë komunë të cilat bazohen, mirëpo nuk janë më të mëdha se, buxheti dhe ndarjet buxhetore të komunës për vitin ekzistues fiskal.

62.3 Nëse – pas datës së përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 20 të këtij ligji, mirëpo para se Kuvendi të ketë bërë miratimin e BKK-së dhe Ligjit për Ndarjet Buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal – kuvendi komunal miraton dhe i dorëzon Ministrin propozim-buxhetin komunal dhe kërkesën për ndarje buxhetore, Ministri duhet që menjëherë t'ia dorëzojë këto dokumente Qeverisë e cila menjëherë i'a dorëzon këto dokumente Kuvendit. Kuvendi mundet, mirëpo nuk është i detyruar, që t'i marrë parasysh këto dokumente gjatë finalizimit dhe miratimit të BKK dhe Ligjit për Ndarjet Buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal.

62.4 Nëse – pasi që Kuvendi ta miratojë BKK-në dhe Ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal – kuvendi komunal miraton dhe i dorëzon Ministrin propozim-buxhetin komunal dhe kërkesën për ndarje buxhetore, Ministri duhet që menjëherë t'ia dorëzojë këto dokumente Qeverisë e cila menjëherë i'a dorëzon këto dokumente Kuvendit. Kuvendi mundet, mirëpo nuk është i detyruar, që ta ndryshojë BKK-në dhe Ligjin për Ndarjet Buxhetore për t'i pasqyruar dokumentet e dorëzuara.

62.5 Nëse kuvendi komunal dështon që ta miratojë dhe t'ia dorëzojë Ministrin propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore deri me 1 Mars, atëherë asnjë shpenzim nuk duhet të bëhet nga ose në emër të komunës në fjalë deri në kohën kur kuvendi komunal ta miratojë dhe t'ia dorëzojë Ministrin këto dokumente. Pas miratimit dhe dorëzimit të këtyre dokumenteve të Ministrit nga kuvendi komunal, këto dokumente i nënshtrohen procedurës së paraparë në paragrafin 4 të nenit 62 të këtij ligji.

PJESA XII

Financimi i Agjencive të Pavarura dhe Gjykatave

Neni 63

Zbatimi i këtij ligji për Agjencitë e Pavarura dhe Gjykatat

63.1 Përveç nëse shprehimisht është përcaktuar ndryshe në këtë Pjesë, të gjitha dispozitat e këtij ligji zbatohen për agjencitë e pavarura dhe gjykatat, njëloj si edhe për organizatat e tjera buxhetore.

63.2 Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) është i autorizuar dhe ka përgjegjësinë që të veprojë në cilësinë e përfaqësuesit të të gjitha gjykatave të Kosovës në lidhje me përgatitjen dhe dorëzimin e propozim-buxheteve dhe kërkesave të tyre për ndarje buxhetore, në përputhje me këtë ligj.

63.3 Në rast të konfliktit ndërmjet dispozitave të kësaj Pjese dhe dispozitave të një ligji tjetër ose Rregullore të UNMIK-ut, dispozitat e kësaj Pjese mbisundojnë.

Neni 64 **Të Ardhurat e Agjencive të Pavarura dhe Gjykatave**

64.1 Të gjitha paratë ose të ardhurat e mbledhura ose të pranuar nga një agjenci e pavarur ose një gjykatë janë para publike dhe duhet që menjëherë të depozitohen në llogarinë përkatëse zyrtare bankare të krijuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit. Agjencia ose gjykata përkatëse, pas bërjes së depozitit, duhet që menjëherë të dërgojë në Thesar një njoftim me shkrim, në formën e përcaktuar në Rregullat KMF, ku paraqet (i) shumën e përgjithshme të depozituar, (ii) një klasifikim sipas burimit të fondeve të depozituara, dhe (iii) të gjitha informatat e tjera të cilat kërkohen sipas Rregullave KMF.

64.2 Nëse një ligj ose Rregullore e UNMIK-ut përcakton se fondet e mbledhura ose të pranuar nga një agjenci e pavarur ose një gjykatë duhet të shfrytëzohen ekskluzivisht nga ajo agjenci e pavarur ose gjykatë, atëherë ato fonde janë të ardhura të dedikuara të asaj agjencie të pavarur ose gjykate. Në raste të kështilla, Thesari do të krijojë një llogari ose nën-llogari të veçantë në Fondin e Konsoliduar të Kosovës për ato fonde të dedikuara.

Neni 65 **Procesi i buxhetimit për agjencitë e pavarura dhe gjykatat duhet të jetë i lirë nga ndikimet politike dhe afariste**

65.1 Asnjë organizatë buxhetore, autoritet publik, person ose ndërmarrje nuk duhet të shfrytëzojë ose të tentojë të shfrytëzojë procesin e buxhetimit ose atë të ndarjes buxhetore të një agjencie të pavarur ose një gjykate në një mënyrë që ka për qëllim ushtrimin e ndikimit politik, personal ose komercial në agjencinë e pavarur ose gjykatën.

65.2 Në rastin e agjencisë së pavarur rregullatore, asnjë autoritet publik, person ose ndërmarrje mbi të cilin ushtron pushtet agjencia në fjalë nuk mund të marrë pjesë ose të tentojë të ndikojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi në procesin e buxhetimit ose atë të ndarjes buxhetore për agjencinë në fjalë. Kjo ndalesë po ashtu vlen dhe duhet të respektohet plotësisht nga të gjitha autoritetet publike ose zyrtarët të cilët kanë rol udhëheqës, rol në politikë bërje ose rol tjetër në industrinë ose fushën e rregulluar nga agjencia.

65.3 Në rastin e një gjykate, asnjë autoritet publik, person ose ndërmarrje – përveç KGJK-së, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe Kuvendit – nuk do të marrë pjesë ose të tentojë të ndikojë, drejtpërdrejt apo tërthorazi, në procesin e buxhetimit ose atë të ndarjes buxhetore për gjykatën në fjalë.

Neni 66 **Agjencitë e Pavarura me të hyra të përcaktuara**

66.1 Gjatë procesit të buxhetimit për një agjenci të pavarur me të hyra të përcaktuara, as Ministri dhe as Qeveria nuk janë të autorizuar që të bëjnë ndryshimin e propozim-buxhetit ose kërkesës për ndarje buxhetore të një agjencie të pavarur ose gjykatave, nëse ky dokument është dorëzuar deri në datën e përcaktuar në qarkoren buxhetore dhe në përputhje me formën e kërkuar në qarkore. Nëse dokumenti nuk është dorëzuar Ministrimit deri në datën e përcaktuar, Ministri është i autorizuar që të përgatisë

propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore për agjencinë përkatëse të pavarur të cilat duhet të bazohet, mirëpo të mos jenë më shumë, se buxheti dhe kërkesa për ndarje buxhetore për vitin aktual fiskal.

66.2 Ministri dhe Qeveria duhet të sigurojnë që të gjitha këto propozim-buxhete dhe kërkesa për ndarje që i referohen paragrafin 1 të këtij neni, (i) të inkorporohen, pa ndryshime, në propozim-BKK-në dhe propozim-Ligjin për Ndarjet Buxhetore, dhe (ii) t'i dorëzohen Kuvendit. Megjithatë, Ministri mundet, në një dokument të veçantë, po ashtu t'i dorëzojë Kuvendit komente lidhur me cilindo propozim-buxhet apo kërkesë të këtillë për ndarje buxhetore.

PJESA XIII

Procedurat Gjyqësore dhe të Arbitrazhit që përfshijnë një Autoritet Publik

Neni 67

Procedurat e ardhshme gjyqësore ose të arbitrazhit

67.1 Nëse, në cilëndo kohë pas hyrjes në fuqi të kësaj Pjese XIII, një person ose organizatë paraqet në gjykatë ose tribunal të arbitrazhit një ankesë ose kërkesë kundër një autoriteti publik me anë të së cilës kërkohet kompensim monetar ose kompensim tjetër nga autoriteti publik, apo një ankesë ose kërkesë me të cilën pretendohet një e drejtë në ose mbi pronën e cila është në pronësi ose posedim të një autoriteti publik ose nën administrimin e një autoriteti publik, personi ose organizata në fjalë ("parashtruesi i ankesës") duhet t'i sigurojë një kopje të kësaj ankesë ose kërkesë autoritetit përkatës publik, Ministrin të Drejtësisë dhe Ministrin të Ekonomisë dhe Financave.

67.2 Kjo ankesë ose kërkesë nuk do të konsiderohet nga asnjë gjykatë ose tribunal i arbitrazhit se është paraqitur në mënyrë të rregullt dhe me kohë, përveç nëse dhe përderisa parashtruesi i ankesës t'i ketë përmbushur në tërësi kërkesat e paragrafit 1 të këtij neni. Kjo ankesë ose kërkesë, nga pikëpamja juridike, do të konsiderohet se është paraqitur vetëm në datën kur kërkesat e paragrafit 1 të këtij neni të jenë përmbushur plotësisht; dhe çfarëdo afate kohore statutores do të vazhdojnë të zbatohet përderisa këto kërkesa të jenë përmbushur. Gjykata ose tribunali i arbitrazhit nuk do të caktojë, urdhërojë, iniciojë ose ushtrojë asnjë procedurë e cila ndërlidhet me ankesën ose kërkesën përderisa parashtruesi i ankesës të ketë dorëzuar në gjykatë ose tribunal të arbitrazhit prova të arsyeshme mbi përmbushjen e kërkesave të sipër cekura.

67.3 Nëse autoritet përkatës publik është Qeveria, Ministria e Drejtësisë ka të drejtën, autorizimin dhe detyrimin që ta përfaqësojë Qeverinë në procedurat përkatëse.

67.4 Nëse autoritet përkatës publik nuk është Qeveria, Ministria e Drejtësisë ka të drejtën dhe autorizimin që të marrë pjesë në procedurat përkatëse si avokat publik dhe, sipas nevojës, si avokat i interesave shoqërore dhe në këtë cilësi do të ketë drejtën dhe autorizimin për të marrë pjesë plotësisht në të gjitha procedurat gjyqësore ose procedura të arbitrazhit të cilat kanë të bëjnë me ankesën ose kërkesën e sipër cekur, duke përfshirë të drejtën që të paraqesë prova dhe argumente juridike kundër ankesës ose kërkesës. Ministria e Drejtësisë gjithashtu është e detyruar që të sigurojë që autoriteti përkatës publik të përfaqësohet në mënyrë të rregullt dhe kompetente nga ana e avokatëve të tij gjatë gjithë kësaj procedure. Ministria e Drejtësisë ka të drejtën dhe autorizimin që të marrë përsipër përfaqësimin e autoritetit publik nëse (i) kjo kërkohet nga autoriteti publik; ose (ii) nëse Ministria e Drejtësisë përcakton, se autoriteti përkatës publik nuk është duke u përfaqësuar në mënyrë të rregullt ose kompetente.

67.5 Në rastin kur Ministria e Drejtësisë e merr përsipër që ta përfaqësojë autoritetin publik në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, gjykata ose tribunali i arbitrazhit duhet ta lejojë vetëm atë që ta përfaqësojë autoritetin publik në procedurat përkatëse. Gjithashtu, të gjithë zyrtarët, shërbyesit civil, punonjësit dhe kontraktuesit e autoritetit përkatës publik janë shprehimisht të detyruar që të bashkëpunojnë plotësisht me Ministrinë e Drejtësisë dhe menjëherë t'i plotësojnë të gjitha kërkesat e saj

për dokumente apo informata. Mosbashkëpunimi, nga pikëpamja juridike, është bazë e mjaftueshme që një gjykatë kompetente, me kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë, të urdhërojë përjashtimin ose largimin e zyrtarit, shërbyesit civil, punonjësit ose kontraktuesit përkatës. Gjykata duhet t'i ofrojë zyrtarit, shërbyesit civil, punonjësit ose kontraktuesit një mundësi të arsyeshme që ta kontestojë bazën faktike të kërkesës për përjashtim ose largim.

67.6 Nëse, në cilëndo kohë gjatë ose pas pjesëmarrjes në procedurë, Ministria e Drejtësisë ka arsye të besojë se palët apo gjykata ose tribunali i arbitrazhit (ose cilido zyrtar, punonjës ose përfaqësues i tyre) janë duke u përfshirë ose mund të jenë përfshirë në vepra të paligjshme, joprofesionale ose jo etike të cilat kanë pasur ndikim negativ në përfaqësimin e autoritetit publik ose përndryshe kanë paragjykuar paratë publike, pronën në pronësi publike ose shoqërore, burimet ose të drejtat ose detyrimet e një autoriteti publik, Ministria e Drejtësisë ka autorizim të plotë që të hetojë këtë çështje si dhe të kërkojë nga cilido person ose autoritet publik (duke përfshirë, mirëpo pa u kufizuar, nga gjykata ose tribunali i arbitrazhit, palët, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Auditori i Përgjithshëm) që të bashkëpunojnë dhe/ose ndihmojnë në kryerjen e këtij hetimi.

67.7 Nëse hetimi i përmendur në paragrafin 6 të këtij neni, zbulon prova të sjelljes së paligjshme, joprofesionale ose jo etike, Ministria e Drejtësisë e dërgon çështjen te Prokurori Publik dhe/ose, nëse është e nevojshme, te autoriteti publik ose organi përgjegjës për zbatimin e standardeve të rregullave të mirësjelljes në gjyqësor, shërbim civil ose nga organi përgjegjës për zbatimin e standardeve profesionale. Nëse kjo çështje i dërgohet Prokurorit Publik, ai/ajo do të ndjek penalisht të gjithë personat dhe organizatat deri në masën e lejuar sipas ligjeve të zbatueshme penale në Kosovë. Nëse çështja i dërgohet një autoriteti publik apo organi tjetër përgjegjës për zbatimin e standardeve të mirësjelljes në gjyqësor, shërbim civil ose standardeve për mirësjelljes profesionale, atëherë ky autoritet publik ose organ do të kryejë një hetim dhe një dëgjim të plotë mbi çështjen; nëse vërtetohet se sjellja jo etike ose joprofesionale ka ndodhur, autoriteti publik ose organi do të ndër marrë masat më të ashpra të mundshme disiplinore për të dënuar shkeljen e këtyre standardeve.

67.8 Nëse Ministri i Drejtësisë konstaton se sjellja e këtuilë i ka shkaktuar dëm parasë publike, pronës apo burimeve publike ose shoqërore apo të drejtave ose detyrimeve të një autoriteti publik, përveç masave të përcaktuara në paragrafin 7 të këtij neni, Ministria e Drejtësisë mund të paraqesë padi civile për dëme ndaj personave përgjegjës dhe nëse është e zbatueshme rikthimin e pronës përkatëse.

Neni 68 Rastet e Pazgjdhura në Gjykatë

68.1 Nëse, në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ka raste të pazgjdhura në gjykatë, që bazohen në një ankesë ose kërkesë të përshkruar në paragrafin 1 të nenit 67 të këtij ligji, dhe Ministria e Drejtësisë nuk është pjesëmarrëse në këtë rast: (i) rasti, për nga pikëpamja juridike, automatikisht pezullohet, dhe (ii) cilido autoritet publik ose gjykatë e cila ishte e përfshirë në rastin e pazgjdhur ose një rast të mëhershëm i cili ndërlidhet me këtë çështje, menjëherë duhet ta njoftojë Ministrin dhe Ministrinë e Drejtësisë mbi rastin dhe duhet t'u sigurojë këtyre ministrive një kopje të plotë të lëndës. Pezullimi vazhdon deri në skadimin e një afati prej 180 ditësh i cili fillon në datën kur kopja e lëndës gjyqësore i është dorëzuar të dy ministrive. Një procedurë gjyqësore konsiderohet "e pazgjdhur" nëse nuk ka rezultuar në nxjerrjen e një vendimi të prerë (kundër të cilit nuk mund të ushtrohet ankesa).

68.2 Deri në skadimin e afatit së pezullimit të përcaktuar më sipër: (i) gjykata dhe palët nuk mund të ndër marrin, dhe nuk do të ndër marrin, kurrfarë masa në lidhje me rastin e pazgjdhur; duke përfshirë paraqitjen e provave, paraqitjen e shkresave dhe/ose marrjen apo nxjerrjen e një vendimi, urdhri apo përfundimi, dhe (ii) të gjitha periudhat dhe afatet kohore (duke përfshirë afatet për paraqitjen e ankesave) të cilat ndërlidhen në çfarëdo mënyre me këtë rast si dhe të gjitha urdhrat ose vendimet e nxjerra në lidhje me këtë procedurë do të pezullohen.

68.3 Si përjashtim nga paragrafi 2 të këtij neni, Ministria e Drejtësisë, gjatë periudhës kur një rast është i pezulluar mund të ndërhyjë në këtë rast dhe ka të drejtat dhe autorizimet e përcaktuara në paragrafët 3,4 dhe 5 të nenit 67 të këtij ligji. Pas skadimit të afatit të pezullimit, gjykata do të rifillojë

procedurën përkatëse; megjithatë, gjykata do të mbajë vetëm ato dëgjime dhe do të nxjerrë ato vendime dhe urdhra (duke përfshirë nëse është e nevojshme revokimin apo ndryshimin e vendimit apo urdhrin paraprak të nxjerrë nga gjykata) që janë të nevojshme për zgjidhjen e drejtë të rastit duke marrë parasysh provat, argumentet juridike dhe parashtesat e paraqitura nga Ministria e Drejtësisë.

68.4 Nëse, në cilëndo kohë Ministria e Drejtësisë ka arsye të besojë se palët dhe/ose gjykata (apo cilido zyrtar, punonjës apo përfaqësues i tyre) janë duke u përfshirë ose mund të jenë përfshirë në vepra të paligjshme, joprofesionale ose jo etike të cilat kanë pasur ndikim negativ në përfaqësimin juridik të autoritetit publik ose përndryshe kanë paragjykuar paratë publike, pronën në pronësi publike ose shoqërore, burimet ose të drejtat ose detyrimet e një autoriteti publik, Ministria e Drejtësisë ka të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në paragrafët 6, 7 dhe 8 të nenit 67 të këtij ligji.

Neni 69 Dëmet e lejueshme

Gjykata kompetente është e autorizuar që ta urdhërojë një autoritet publik ose organizatë buxhetore që të paguajë kompensim monetar vetëm për dëme të drejtpërdrejta ekonomike të cilat janë vërtetuar nga gjykata në bazë të provave.

Neni 70 Konflikti ndërmjet kësaj Pjese XIII dhe akteve tjera ligjore

Kjo Pjesë do të mbisundojë mbi të gjitha dispozitat kundërthënëse në një ligj tjetër apo Rregullore të UNMIK-ut, përveç nëse ai ligj apo rregullore shprehimisht përcakton se ato dispozita kundërthënëse do të mbisundojnë mbi një apo më shumë dispozita të kësaj Pjese.

Neni 71 Njoftimi i gjykatave, autoriteteve publike dhe Odës së Avokatëve

Menjëherë pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Pjese, Ministria e Drejtësisë do t'u dërgojë një njoftim të veçantë të gjitha gjykatave, IGJK-së, KGJK-së, Odës së Avokatëve dhe zyrave ligjore të të gjitha organizatave buxhetore dhe autoriteteve publike, me të cilin këto organe njoftohen lidhur me dispozitat e kësaj Pjese. Pas pranimit të njoftimit, IGJK, KGJK dhe gjykatat duhet të sigurojnë që një kopje e njoftimit t'u dërgohet të gjithë gjykatësve në Kosovë. Pas pranimit të njoftimit, Oda e Avokatëve duhet të sigurojë që një kopje e njoftimit t'u dërgohet të gjithë avokatëve në Kosovë.

Neni 72 Ndarjet plotësuese buxhetore

Nëse në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Pjese, Ligji Vjetor për Ndarjet Buxhetore i cili është në fuqi gjatë atij viti nuk i ofron Ministrisë së Drejtësisë mjete të mjaftueshme për ushtrimin e përgjegjësive të cilat i janë dhënë asaj me nenet 67 dhe 68 të këtij ligji, Ministri i Ekonomisë dhe Financave (i) menjëherë do të konsultohet me Ministrin e Drejtësisë lidhur me financimin e nevojshëm, dhe (ii) i dorëzon Qeverisë për miratim dhe dorëzim në Kuvend një propozim-ndryshim plotësim të ligjit aktual për Ndarjet Buxhetore për t'i dhënë Ministrisë së drejtësisë një ndarje plotësuese buxhetore e cila me arsye pritet se do t'i lejojë Ministrisë së Drejtësisë që t'i ushtrojë këto përgjegjësi.

PJESA XIV Dispozitat penale dhe çështjet përfundimtare

Neni 73

Mos-Depozitimi i Parave Publike në Fondin e Konsoliduar të Kosovës

73.1 Nëse organizata buxhetore, autoriteti publik ose ndërmarrja e kontrolluar publike nuk i depoziton me shpejtësi paratë publike në Fondin e konsoliduar të Kosovës, ose sa ka të bëjë me përkrahjen financiare të pranuar nga një komunë nga Republika e Serbisë, në një llogari komerciale bankare siç lejohet nga LFPL, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit duhet të bëjë një vlerësim të shumave të cilat nuk janë depozituar dhe t'ia dërgojë vlerësimin Ministrit, i cili më pas i'a përcjell këtë vlerësim Auditorit të Përgjithshëm.

73.2 Auditori i Përgjithshëm menjëherë e heton çështjen dhe, nëse e konsideron të nevojshme ose të arsyeshme, ia përcjell rastin zyrtarëve përkatës për zbatimin e ligjit

Neni 74

Mbledhjet e Paligjshme

Nëse me një vendim të plotfuqishëm ose urdhër të një gjykate është konstatuar se paratë, të ardhurat apo shumat janë ngarkuar, mbledhur ose pranuar pa autorizim të ligjshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, pasi që t'i jetë siguruar ky vendim i plotfuqishëm ose urdhër, duhet menjëherë t'i veçojë këto fonde të cilat gjinden në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe duhet t'i mbajë këto fonde në një llogari të veçantë të mirëbesimit. Fondet në llogarinë e mirëbesimit trajtohen sipas urdhrit të gjykatës.

Neni 75

Mos përputhja me këtë ligj

Përveç çështjeve të rregulluara me nenin 62 dhe paragrafin 4 të nenit 65 të këtij ligji, nëse Ministri konstaton se një organizatë buxhetore nuk u është përmbajtur në bazë të rregullt kushteve dhe procedurave sipas këtij ligji, ai duhet të nxjerrë një konstatim me shkrim dhe t'i dërgojë një kopje të këtij konstatimi organizatës buxhetore, Kryetarit të Kuvendit dhe Kryesuesit të Komisionit për Buxhet të Kuvendit dhe Auditorit të Përgjithshëm. Nëse organizata buxhetore është komunë, Ministri duhet që t'i dërgojë një kopje të këtij konstatimi gjithashtu kuvendit përkatës komunal. Nëse organizata buxhetore nuk është komunë, Ministri duhet që t'ua dorëzojë një kopje të konstatimit gjithashtu edhe anëtarëve të Deverisë. Auditori i Përgjithshëm, pas pranimit të konstatimit, do të kryejë një hetim të çështjes.

Neni 76

Ndikimi i paligjshëm

76.1 Do të konsiderohet vepër penale, për çdo person apo ndërmarrje që të sigurojë, të ofrojë, kërkojë, pranojë çfarëdo gjëje me vlerë për dobi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të një të punësuarit apo ish të punësuarit të autoritetit publik apo të ndonjë zyrtari publik apo të një ish zyrtari publik, plotësisht apo pjesërisht, me qëllim të influencimit në një vendim që ndikon në mbledhjen, disponimin, shfrytëzimin ose shpenzimin e çfarëdo paraje publike .

76.2 Gjithashtu do të konsiderohet vepër penale për çdo person apo ndërmarrje që të ndërmarrë çfarëdo veprimi me qëllim të frikësimit, të shtrëngimit, të dëmtimit apo të nxitjes (fizike, financiare apo tjetër) ndaj çfarëdo personi apo ndërmarrësi tjetër plotësisht apo pjesërisht, me qëllim të ndikimit në një vendim që ndikon në mbledhjen, disponimin, shfrytëzimin ose shpenzimin e çfarëdo paraje publike.

76.3 Çdo person apo ndërmarrje që dënohet për ndonjërin nga veprat penale të saktësuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni do të paguaj dënimin prej 10,000 deri në 500,000 Euro, gjykata përkatëse do të përdorë diskrecionin e arsyeshëm me rastin e përcaktimit të shumave të sakta të dënimeve të tilla, duke marrë parasysh karakterin e saktë të veprës së tillë (përkatëse). Çdo person apo ndërmarrje e dënuar, gjithashtu, ndalohet që për një periudhë prej më së paku pesë (5) viteve (i) të angazhohet në

cilësinë e shërbyesit civil, zyrtarit ose konsulentit nga një autoritet publik, dhe (ii) të kryejë çfarëdo aktiviteti afarist ose të lidhë çfarëdo kontrate me një autoritet publik, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Nëse personi në fjalë është zyrtar publik ose nëpunës i një autoriteti publik, ai ose ajo do të përjashtohet dhe do ti ndalohet mbajtja e një posti publik, punësimi në një post në shërbimin civil si dhe mbajtja e një posti në një ndërmarrje publike për një periudhë prej dhjetë (10) viteve.

76.4 Çdo person i dënuar për ndonjërin nga veprat penale të saktësuara në paragrafin 2 të këtij neni do të burgoset me kohëzgjatje prej një viti apo me dyfishin e kohëzgjatjes së barabartë me kohëzgjatjen e cila është e zbatueshme sipas ligjeve të përgjithshme penale dhe rregulloreve në Kosovë për një vepër të tillë penale. Dënimi që është më afatgjatë do të zbatohet.

76.5 Kur një vepër penale e saktësuar në paragrafët 1 ose 2 të këtij neni supozohet se është kryer nga ose në emër të një ndërmarrje, personi fizik ose personat e përfshirë në ngjarjen e cila ka shkaktuar një kundërvajtje të tillë, gjithashtu, do të ndiqen penalisht. Gjithashtu, çdo drejtor, menaxher i lartë ose zyrtar ekzekutiv i një ndërmarrje të tillë, i cili ka ditur apo është dashur të dijë ngjarjet që kanë paraprirë kundërvajtjen e tillë, gjithashtu, do jetë përgjegjës penalisht nëse në kohën kur ky person ka ditur ose është dashur të dijë për këto ngjarje, ky person nuk ka marrë masa të menjëhershme dhe serioze për ta parandaluar shkeljen ose për t'a raportuar atë para Ministrit të Punëve të Brendshme ose Prokurorit Publik.

Neni 77

Shkeljet nga zyrtarët publik apo shërbyesit civil

77.1 Nëse ndonjë zyrtar publik ose shërbyes civil me qëllim dështon, apo më shumë se një herë dështon me neglizhencë, t'u bindet një apo me tepër herë obligimeve dhe kërkesave të vendosura nga ky ligj apo një akt normativ ose urdhër të vlefshëm që është lëshuar nën autoritetin e këtij ligji, zyrtari publik ose shërbyesi civil do të përjashtohet dhe do t'i ndalohet punësimi në shërbimet publike për një periudhë së paku tre (3) trevjeçare.

77.2 Nëse një zyrtar publik ose shërbyes civil me qëllim dështon t'i përmbushë një apo më shumë detyrime të themeluara me këtë ligj apo me një akt nën lidhor ose urdhër të vlefshëm të nxjerrë në bazë të këtij ligji, ky person është subjekt i një gjobe administrative deri në 10,000 Euro. Nëse një dështim i tillë i qëllimshëm i shkakton dëme një organizate buxhetore ose humbje të parave publike, zyrtari publik apo shërbyesi civil po ashtu është përgjegjës për të gjitha dëmtimet apo humbjet e tilla. Nëse, në bazë të ligjeve dhe rregulloreve të përgjithshme penale të Kosovës, sjellja e këtyre konsiderohet vepër penale, personi në fjalë po ashtu është subjekt i ndjekjes penale sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

77.3 Nëse një zyrtar publik apo shërbyes civil, me neglizhencë flagrante, dështon që të përmbushë një detyrim të vendosur nga ky ligj apo nga një akt nënligjor ose urdhër i nxjerrë në mënyrë të vlefshme në bazë të këtij ligji, dhe ky dështim i shkakton dëme një autoriteti publik ose humbje të parave publike, zyrtari publik ose shërbyesi civil është përgjegjës për dëmtimet dhe humbjet e këtyre.

Neni 78

Suspendimi i zyrtarit publik dhe shërbyesve civil

Nëse një zyrtar publik apo shërbyes civil bëhet subjekt i një procedure gjyqësore ku janë shfaqur dyshimet se zyrtari apo shërbyesi i tillë ka qenë i përfshirë në një ngjarje të paligjshme, siç është përshkruar në nenin 76 të këtij ligji ose ka dështuar me qëllim apo për shkak të neglizhencës t'u bindet një apo disa obligimeve apo kërkesave të përcaktuara sipas këtij ligji apo sipas një akti apo urdhri plotësues normativ të nxjerrë në mënyrë të vlefshme nën autoritetin e këtij ligji, gjykata mund të nxjerrë një urdhër me të cilin e suspendon një person të tillë nga pozita e tij/saj, me pagesë, deri në kohën kur gjykata të mbajë një seancë të plotë dhe të drejtë lidhur me dyshimet dhe të marrë vendim.

Neni 79

Shkeljet nga personat e tjerë

Nëse një person tjetër përveç zyrtarëve publik apo shërbyesve civil bën shkeljen e dispozitave të këtij ligji apo të një akti ose rregullore normative, të nxjerrë në mënyrë të vlefshme në bazë të këtij ligji, ky person është fajtor për vepër penale dhe duhet të paguajë një gjobë nga 10,000 deri në 500,000 Euro,

gjykata përkatëse do të përdorë diskrecionin e arsyeshëm me rastin e përcaktimit të shumës së saktë të gjobës, marrë parasysh karakterin e saktë të veprës penale. Nëse shkelja e sipër cekur i shkakton dëme një organizate buxhetore ose humbje të parave publike, personi në fjalë po ashtu është përgjegjës për të gjitha dëmtimet dhe humbjet e tilla. Nëse kjo shkelje përfshin vepra të cilat konsiderohen vepra penale sipas ligjeve dhe rregulloreve të përgjithshme penale të Kosovës, personi në fjalë po ashtu do të jetë subjekt i ndjekjes penale sipas ligjeve dhe rregulloreve në fjalë.

Neni 80 Ndalimi i Kompensimit Shtesë

Nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, sipas një akti të Qeverisë, kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik, ky punonjës, shërbyes civil ose zyrtar nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur.

Neni 81 Hyrja në fuqi/Shfuqizimi i legjislacionit paraprak/Zbatueshmëria

81.1 Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen si vijon: (i) Ligji Nr. 2003/2, (ii) Rregullorja e UNMIK-ut 2003/17 e 12 Majit 2003 për shpalljen e këtij ligji, dhe (iii) të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e të sipër cekurave.

81.2 Dispozitat e këtij ligj të cilat themelojnë kushte dhe procedura të buxhetimit dhe për ndarjet buxhetore nuk zbatohen për AQBK-në.

81.3 Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës

Me datën : 13.03.2008

Lista A Njësitë e përcaktuara

Secila nga njësitë në vijim është "njësi e përcaktuar" me nënkuptimin e kësaj fjale (i/e përcaktuar) në mënyrën se si fjala e lartpërmendur përdoret në këtë ligj.

- 1) Posta dhe Telekom i Kosovës
- 2) Autoriteti i Energjisë Elektrike të Kosovës
- 3) Autoriteti i Aeroportit të Prishtinës
- 4) Hekurudhat e Kosovës
- 5) KOSTT

Lista B Institucionet ndërkombëtare financiare

Në vijim gjinden institucionet ndërkombëtare financiare të cilat janë të përmendura në nenin paragrafin 1 të nenit 46 të këtij ligji:

- 1) Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe anëtarët e tjerë të Bankës Botërore
- 2) Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
- 3) Fondi Monetar Ndërkombëtar
- 4) Banka Islamike për Zhvillim
- 5) Agjensionet zyrtare për përkrahjen (financimin) e eksportimit

- 6) Institucionet zyrtare financiare bilaterale të vendeve të jashtme ose të Bashkimit Evropian.
- 7) Banka Evropiane e Investimeve